

STAVRI PONE

LOTËT E TRËNDAFILIT

Roman

Tiranë

Redaktor: **Granik DANI**

Kopertina: **Alfred DRAGUSHA**

Botim i tretë

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Çdo ngjashmëri me ngjarje e persona realë është krejt e rastit.
Autori

Pranverës

Liria e individit nuk është dhuratë e qytetërimit. Ajo ka qenë ndjenja më e madhërishme përpara se të kishite lindur çdolloj qytetërimi.

Zigmund Frojd

Nga vetë natyra e saj, **dashuria** është hyjnore dhe pikërisht për këtë arsye ajo jo vetëm është jopolitike, por antipolitike, dhe ndoshta është më e fuqishmja nga të gjitha forcat antipolitike njerëzore.

Hana Arendt

1

Dola nga burgu më 17 mars 1991, ditën e enjte, dhe në darkë vonë mbërrita në qytetin tim, në shtëpinë time në lagjen *1 Maji*, ku isha lindur, kisha kaluar fëmininë, adoleshencën dhe vitin e parë të martesës. Pjesën tjetër të kohës, deri kur më arrestuan, e kisha kaluar në fakultet dhe në shtëpinë e tezes sime, Zogës, që unë e ime motër Flora i thoshim *jajë*.

Unë, libert¹ i shekullit të 20-të, i mbijetuar i fshesës së hekurt të spastrimit komunist, vija nga burgu gjysmë i çmendur. Hiq paraburgimin, gjithë kohën e burgut, 10 vjet e 3 muaj, që ishte më pak se gjysma e kohës së dënimit tim total prej 22 vjetësh bashkë me ridënimin, e kisha vuajtur në një kamp në thellësi të maleve në Veri. Si i ridënuar më duhej të bëja edhe 12 vjet të tjerë. Babi dhe jaja kishin vdekur kur isha në burg.

Nuk e harroj atë natë kur vura këmbë sërish në qytetin tim pas kaq vitesh. Kur zbrita nga autobusi më priste Flora me të shoqin, Nardi Sofronin, dhe desha të shkoja te shtëpia e jajës, po Flora më tha me lot në sy se ajo nuk ekzistonte më, e kishin prishur dhe në vend të saj kishin ndërtuar një kopsht fëmijësh, kështu që kot të shkoja. Gati ulërita, më theri në zemër, më plagosën ciflat e kujtimeve për të dhe u nisa të shkoja, doja të shihja se mbase kishte mbetur diçka prej saj, një pjesë gardhi, ose *akacia*. Po akacia? pyeta Florën duke britur dhe ajo më pa me shqetësim. Akacia? mërmëriti. Ç'rëndësi ka akacia? Nuk ka rëndësi, po dua ta di: është apo e kanë prerë. Nuk e di, tha e pasigurt, më duket se është.

U gëzova dhe ndjeva të më rignonin lotët faqeve deri në mjekrën e dendur, që kishte filluar të thinjej. *Të paktën të ketë shpëtuar akacia*, lutesha me vete, dëshmitarja e heshtur që më ishte ngulur thellë në shpirt, që lidhej me diçka të shenjtë, anën e jashtme të së cilës Flora

¹ skllav i liruar

e dinte, po jo të brendshmen, se njeriu ka edhe një anë të brendshme thellë qenies së tij, që e quan në fshehtësi tempull, altar, që nuk shembet kurrë çfarëdo shembjeje t'i ndodhë objektit që lidhet me të dhe akacia, bukuroshja ime, që më ishte shfaqur në pamjen e saj reale përpara syve edhe në burg, edhe në kthjelltësitë e çmendurisë sime, dhe që kishte qenë e vetmja gjë që më ngushëllonte, mbase kishte mbetur. Kisha besuar se një ditë do ta shihja dhe pamja e saj do të bënte çudinë, do të më shëronte nga makthet dhe turbullirat e mia.

Iu binda Florës dhe nuk shkova të shihja mungesën e shtëpisë së jajës, por, bekuar qoftë, atje qe ngritur një kopsht fëmijësh dhe lutesha që ata fëmijë të mos përjetonin kurrë dhimbje si të miat, që historitë si imja t'i mësonin vetëm nëpër libra, le t'i quanin edhe përralla, po veç të mos e njihnin vuajtjen nga diktatura.

Flora dhe Nardi më kapën nga krahët dhe morëm rrugën e shtëpisë, çka e kuptova se po ecnim mbi urën që lidhte sheshin përpara bankës me rrugën e Patosit. Nardi mbante thesin tim të vogël, të ronitur e të ngrënë, që kishte brenda çikërrimat që i kisha përdorur në burg si dhe atë palo thesar, që mezi e kisha shpëtuar - Biblën e atë Palit dhe bllokun me *esetë* që kisha shkruar në burg e që do të më vinte keq po të më kishte humbur.

I hodha një sy Florës, fytyrën e bukur të së cilës ma shfiguronte perdja e lotëve. I kishte ikur freskia e dikurshme, megjithatë mbahej, ishte po ajo fytyrë e dashur, me sy të mëdhenj, të zes, me hundën të hollë e të harkuar hijshëm, paksa majuce, me buzët e plota që vetëm dinin të qeshnin, pastaj pashë nga Nardi, babaxhan burrë, i urtë e i qetë, me flokët bojë kashte me onde të shtruara me zor, me sytë e përhimët e me atë zërin buçitës që i magjepste spektatorët kur dilte në skenë.

Kur po i afroheshim shtëpisë Flora më tha se me ardhjen e demokracisë e kishin marrë prapë në punë si aktore në teatrin e qytetit, çka më gëzoi pa masë. E ndieja veten fajtor: për shkakun tim kishte vuajtur shumë, jo vetëm ajo, por edhe familja ime. Prindërit vërtet nuk i kishin nxjerrë nga puna, mamanë e lanë në punën ku kishte qenë, kuzhinieri në një kopsht fëmijësh të lagjes, dhe babin hidraulik në Komunale. Si rregull duhej t'i kishin internuar, t'i kishin degdisur në ferma a kampe të internuarish, po nuk e kishin bërë dhe nuk e di pse. Vetëm Florën kishin hequr si aktore, kurse Nardin jo. Kishte raste kur diktatura tregohej disi e mëshirshme, me siguri për të mirën e saj, jo të njerëzve, për ta zbutur sadopak imazhin e llahtarshëm të egërsisë për të cilën me

siguri ishte më se e vetëdijshme.

Po binte muzgu kur mbërritëm në shtëpi, në shtëpinë e fëminisë dhe të rinisë sime të parë, ndërtuar në faqen e kodrës, në një pjerrinë të butë nga ku hapet një peizazh i mahnitshëm që edhe natën të rrëmben me magjinë e tij, ku shtëpitë matanë rrugës së Patosit, ashtu të vogla e të strukura mes pemëve e hardhive, por edhe të mëdhatë, disa pallate të ndërtuar rishtazi, që para burgimit tim nuk ekzistonin, të ngjallnin në shpirt ndjenjën e jetës, sidomos shtëpitë me kopshte, ah, dy njerëzit e parë të botës në kopsht kishin jetuar dhe ndoshta prej tyre e trashëgojmë genin e përjetshëm transhental¹, parahistorik, të dashurisë për gjelbërimin, për një fije bari, për një gjethez të njomë, dhe mbi ato shtëpi nuk kishte gryka armësh, nuk flinte vdekja e gatshme të zgjohej në çdo çast, dhe qielli atë natë marsi, për fatin tim të mirë, ishte plot me yje, jo yje burgu, mëshirues, që ndonëse të paburgosur na dukeshin të tillë, të dënuar edhe ata, po një qiell i lirë, jo vetëm pse kishte ardhur demokracia, por sepse unë po jetoja me harmoninë e vërtetë të natyrës, me paqen e saj qiellore që të krijonte në shpirt një ndjenjë preheje, nirvanën e ëndërruar prej vitesh, dhe tek pashë atë qiell të lirë nga kopshti i shtëpisë sime, i bukur dhe ai, po jo sa kopshti i jajës, i thadruar thellë në një cep të zemrës sime, u mbusha me ngazëllim dhe sikur erdha pak në vete, se çmenduria më shoqëronte në çdo çast dhe më flakte pa mëshirë jashtë realitetit.

Shtëpia ngrihej mbi tarracën e sipërme - oborri ynë kishte edhe një tarracë të poshtme - përtej pemëve frutore dhe një pjergulle të madhe, kishte dy dhoma e një kuzhinë, të mëdha e plot dritë, ishte mbi një metër nga toka, me bimsa poshtë dyshemesë, me një palë shkallë të jashtme çimentoje me shtatë shkallare, me parmakë betoni anash të derdhur në formë të bukur, me një verandë të gjerë plot me lule, dhe në verandë më priste mamaja ime, Diella, me sytë e përshkënditur si me rreze diellore, siç kishte emrin, kurse babi, Thomai, kishte kohë që prehej në varreza në Mbyet, dhe u drodha tek pashë mamanë aq të thinjur, aq të vogël, me ata sy mrekullisht të dashur e të ëmbël, në ngjyrë të bruztë në të gjelbër, sytë e mamasë sime që ishin pasqyra e shpirtit të saj të pastër, dhe m'u hodh në krah e më tha, Tori, shpirt! U përqaftuam, e putha me mall e i pëshpërita, Mama e dashur, e ëmbla ime, shqiptaro-malazezja ime, shyqyr që të gjeta gjallë

¹ I që kalon përtej ideve të zakonshme, njohuri intuitive që nuk lidhet me përvojën konkrete

e shyqyr që arrite të më shohësh gjallë, se mund të mos më kishe parë më kurrë, vdekja më ka kaluar aq shpesh pranë, këto i thashë me vete, jo asaj, po fati deshi të më ruante që të më shihje ti, të shihje djalin tënd të vetëm që t'ua kthye në shtëpi, jo krejt i shëndoshë, me mendjen të gjysmuar, gjysma e tretur diku, nuk dihet se ku, ndoshta labirinteve të mistershme të trurit si të galerive të nëndheshme ku punova dhjetë vjet si skllav.

Hymë në shtëpi e bëra dush. Ah, duart e arta të babit, sa mirë e kishin ormisur atë dush, më çlodhi e ndjeva njëfarë qetie dhe shkova në kuzhinë i veshur me rroba të lara, të buta, të ngrohta, të njomura me dashurinë e nënës sime, me lotët e saj gjatë mungesës sime të gjatë e prapë iu hodha në qafë dhe e puthja papushim dhe e përkëdhelja si fëmijë, gjithnjë e kam përkëdhelur mamanë, siç përkëdhelja edhe jajën, Zogën, motrën e saj plakë, trimëreshën, dukeshën, atë zonjë grua, që edhe ajo s'është më, po që më kishte dashur si bir dhe e kisha dashur si nënë.

Flora me Nardin ndenjën deri vonë e po ashtu xhaxhi Vasili me të shoqen, Lenën, grua shpirtnjëriu, së cilës i thoshim *nao*. Nuk e di pse në fisin tonë përdornim ca emra të veçantë se, për shembull, edhe gjyshes nga nëna i thoshim *majë* dhe gjyshes nga babai *dadë*. Pyeta xhaxhi Vasilin dhe naon pse s'i kishin marrë fëmijët të më takonin, kishin një vajzë e dy djem më të vegjël, dhe më thanë se djemtë ishin në Greqi, në emigracion, kurse vajza ishte martuar në Shkodër.

Xhaxhi Vasili kishte ende atë pamje të sikletosur si dikur - ishte komunist ai, qe prekur në sedër kur nipin e kishin futur në burg për politikë, për agjitacion e propagandë, çka kishte shkaktuar rrëmet në tërë fisin, po ai kishte meritat e veta, kishte marrë pjesë në Luftë që 17 vjeç, kishte luftuar trimërisht dhe burgimi im nuk e kishte cenuar fare emrin e tij të mirë e të panjollë si komunist, madje vazhdonte të ishte jo thjesht komunist, po enverist i flaktë, megjithatë iu shmang bisedave politike. Kurse naoja më shikonte me dhembshuri dhe hera-herës fshinte sytë. Më donte shumë, më kishte dashur që i vogël dhe ishte e lumtur që më shihte gjallë, por pikërisht atë çast, teksa po i përgjigjesha me buzëqeshje ngrohtësisë prej nëne të *naos* dhe sytë më ishin rrëmbushur nga një perde lotësh, tek shihja fytyrat e njerëzve të dashur, rrezëllimin e gotave, reflekset e pijeve në to, ca pikla të derdhura në një pjatë e teksa dëgjoja tringëllimën e lugëve e pirunjve, se Flora kishte përgatitur vërtet një festë, më zuri ajo kllapia e mallkuar dhe u

mërgova nga gjithçka, u ktheva në gjendjen time të mjerueshme, e gjeta veten në galeri tek mbushja vagonin me mineral nën dritën verdhane të llambës me karbit dhe një polic harbut mustaqexhufkë më godiste ligisht me një shkop gome në sup e dhimbja ma çante trupin më dysh dhe duhet të kem bërtitur, Mos, ju lutem, Mos më goditni, zoti polic, e mbusha vagonin, ja, nuk merr më, por mustaqexhufka syegër vazhdonte të më godiste, më godiste edhe brigadier i punës, ai i liri, jo ai i burgosuri, dhe unë vazhdova të bërtisja e të rënkoja me sy të terratisur.

Më vonë Flora më tha se ajo, Nardi dhe xhaxhi Vasili më kishin çuar në dhomë, më kishin dhënë të pija një qetësues, kishin thirrur urgjent mjekun psikiatër, Abazin, shokun tim, po kur mbërriti ai unë ndodhesha në gjumë të thellë. Abazi kishte qëndruar rreth një orë në kuzhinë se mos zgjohesha, kishte lënë një recetë e kishte thënë se do të vinte të më shihte përsëri të nesërmen.

Qetësuesit e bënë punën dhe fjeta deri në drekë. Mamaja kujdesej për mua si atëherë kur isha fëmijë, me po atë merak të tepruar kur më ndiqte pas për të mbaruar së ngrëni pjatën duke më treguar diçka që të më tërhiqte vëmendjen, Tori, shpirt, e shikon atë zogun?, e hëngri farën, hape gojën edhe ti si zogu, dhe unë e hapja dhe ajo më fuste lugën e vogël në gojë. Pale kur vritesha gjatë lojës apo rrëzohesha e bëhesha me gjak, se kam qenë fëmijë i lëvizshëm, ajo alarmohej, kurse babi, kur ndodhej në shtëpi, se zakonisht kthehej vonë, kur unë isha në gjumë, vinte buzën në gaz e i thoshte mamasë me qetësi apostolike se fëmijët kështu e kanë, edhe do të vriten, ndryshe nuk forcohen për t'u bërë burra, dhe kishte të drejtë.

Mamaja po kështu edhe tani, ndonëse tani kishte më shumë arsye për t'u shqetësuar – s'isha më i pari, ai djaloshi i qetë me atë të folur të matur, me arsyetime të kthjellëta e shpesh me humor, i dashur e i sjellshëm, por një tjetër i shpërfytyruar, një 41-vjeçar i dërrmuar jo aq fizikisht, se muskujt e trupit më qenë forcuar dhe trupin e kisha të drejtë si kavak, thoshte ajo, por mendërisht, që shndërrohesh në hijen e vetvetes, e kyçja gojën për orë të tëra dhe shëtitja nëpër kopshtin tonë të pjerrët, me dy taraca, të mbytur nga gjelbërimi, sidomos në verë, duke statujëruar ose duke folur a me vete, a me zogjtë, a me gjethet e pemëve.

Shihja sesi mamaja dilte pa u ndier në verandë apo zbriste shkallët e më kërkonte me sy, nganjëherë më afrohej e më drejtohej me fjalë të buta, mikluese, që të hyja brenda dhe unë vëreja fytyrën e

saj të plakur, shtëllungajën e flokëve të saj të thinjur që rrethonte atë fytyrë aq të bardhë e të bukur dikur, aq fisnike e të ëmbël, krejt e ndryshme nga ajo e së motrës, Zogës, që nuk shquhej për tipare të bukura, po të rregullta e disi të ashpra, autoritare po gjithsesi fisnike, prej *dukeshe*, i thosha unë me shaka, dhe ajo qeshte, me siguri pa e kuptuar fjalën dukeshë.

Një herë nuk iu binda mamasë, por i sokëllita ashpër, Më lër rehat! dhe ajo më tha me përvuajtje, me përdëllim, me një vigmë të thellë së brendshmi, duke më parë me sy të muguallt, Je shuplakur, bir, të bëftë Zoti derman, e m' u dhimbs. U shkitha e iu binda, ika nga oborri e hyra në dhomën time, të rinisë së parë e më pas të martesës, mbetur e pandryshuar që kur qeshë futur në burg, një dhomë si muze trishtimi, me krevatin e madh dopio me ballin bojë arre të zbukuruar me llojloj figurinash që i kishte vendosur ish-ime shoqe, Margarita ose Giti, siç i thërrisnin që fëmijë, me komodinat në të dyja anët e ballinës ku mbaja libra të profesionit tim, fletore shënimesh, jo fletoret e *Shënimeve* që më kishin konfiskuar në prag të arrestimit, me vendin bosh ku dikur qendronte krevati i vajzës sonë, po që pas martesës së Gitit me Saimirin, kur unë isha në burg, Giti e kishte marrë me vete, të vetmen gjë që kishte marrë, veç sendeve vetjake të saj, dhe tryeza e saj e tualetit ishte ende në vendin e vet, por pa bizhutë farfuritëse, shishkat, kutijat e kremrave, fondatinës, rimelit e gjithfarë tubetash, furçash, gërshërësh, pincetash e kësi çikërrimash, pa reflekset e tyre që ende më vizëllonin në sy, sidomos farfuritjet e pasqyrës së bukur vezake ku ajo rregullohej si aktoret përpara daljes në skenë, dhe unë iu afrova pasqyrës instinktivisht, sikur do të gjeja në të një pjesëz të mbetur nga imazhi i fytyrës së saj të bukur që shihja sa herë i thosha diçka përpara se të dilnim së bashku, i flisja fytyrës së saj në pasqyrë pa parë në të fytyrën time, një komunikim herë i këndshëm e herë i tensionuar kur ajo vonohej, se gjithnjë vonohej kur bënte tualet.

Qëndrova gjatë përpara pasqyrës, i vetmi kujtim që më lidhte aq shumë me Gitin, çuditërisht më shumë edhe se krevati ku kishim bërë aq herë dashuri si të dalldisur, por krevati nuk më rikthente aq në të shkuarën ndoshta sepse kishim bërë dashuri edhe në shtëpinë e saj, edhe në vende të tjera, dhe vetëm pasqyra më solli mizorisht në kujtesë fytyrën e saj dhe vendosa ta heq.

Iu futa punës, e hoqa dhe sikur u çlirova nga një makth. Tani do ta përdorja si skrivani ku do të vazhdoja të shkruaja *Shënimet* e mia të kohës përpara burgimit, do të thellohesha në to, por edhe në *esetë* e

burgut e ndoshta do të shkruaja edhe të tjera.

Po sa herë ulesha në tryezë mezi më bëhej të shkruaja dhe stilolapsi më ngecte, mendimet më dilnin të thata, letrat i bëja shuk e i flakja në kosh. Më duheshin *Shënimet* e dikurshme, ndoshta do të nxitesha prej tyre për të shkruar gjëra që të kishin njëfarë vlere. *Shënimet* ishin kopja e atyre që më kishin konfiskuar kur më kishin arrestuar dhe që, disa javë përpara arrestimit, i kishte shtypur Rajmonda me *Olivetti*-n tim. Por ato ndodheshin në shtëpinë e Pilo Dhimoleut, kushërirrit të mamasë, që i kishte fshehur në bufenë e shtëpisë së tij. Kështu që një ditë shkova në shtëpinë e tij për t'i marrë. Piloja kishte vdekur, kurse e shoqja, Sandra, kishte shkuar tek i biri në Greqi. Në shtëpi gjeta Frosinën, vajzën e tyre shurdhmemece, që ishte martuar dhe banonte atje me të shoqin, një burrë i shkurtër, i zeshkët e i thatë. Ajo m'u hodh në qafë dhe qau. E kuptoi se kisha shkuar për shkrimet e mia, u mor vesh me shenja me të shoqin dhe ai hapi bufenë në vendin që i tregoi ajo. U ngazëlleva kur pashë *Shënimet* dhe fletoret me poezi të Marinës, paksa të zverdhura nga koha, por krejt të lexueshme.

Një ditë tjetër i thashë mamasë se do të shkoja të shihja vendin ku dikur kishte qenë shtëpia e jajës. Nuk më rrihej pa shkuar te vendi i një shtëpie të dashur, të vogël, të fshehur mes një kopshti magjik që më qe thadruar thellë në zemër. Mamaja më tha të më shoqëronte, po ia preva ashpër, Do të shkoj vetëm! Më qe bërë fiksime akacia: ishte ende atje, apo e kishin prerë.

Ecja trotuarit të rrugës *Enver Hoxha*, rruga kryesore e qytetit, nuk di nëse quhej më ashtu ajo rrugë, me kokën të ulur që të mos takoja ndonjë të njohur. Pas ndonjë gjysmë ore u ndala. O Zot, mezi arrita të orientohesha. Gjithë lagjja *Belik*, lagjja e jajës, kishte ndryshuar dhe nga shtëpia dhe kopshti i saj nuk kishte mbetur asnjë gjurmë; edhe gardhi ishte zhdukur dhe në vend të tij ishte ndërtuar një mur me kangjella. Përtej murit dukej një ndërtesë dykatëshe: kopshti i fëmijëve. Ende pa mbërritur atje ngriva në vend: akacia nuk dukej kurrkund.

Kaptova portën që binte nga ana ku dikur ishte shtëpia e Athinasë, kunatës së jajës, që edhe ajo ishte prishur, hyra në oborrin e kopshtit dhe hodha sytë te vendi ku akacia ngrihej dikur aq e bukur. Vetëm trangu kishte mbetur përkëtej murit me kangjella, ngjitur me të, as një pëllëmbë mbi tokë, me nja dy filiza të blertë anash.

Sa nuk u çmenda nga dhimbja. U ula e putha tokën, putha edhe trungun e akacies dhe u gërvishta në faqe nga gjambat e filizave. Pastaj ngrita sytë lart, te dritarja e pallatit ku dilte *Ajo*. Ishte e mbyllur, me kortinka të bardha, dhe rrezet e perëndimit përthyheshin në qelqet e saj si të përgjakura. Ishte e vetmja gjë që kishte mbetur si dikur. Për mua nuk ishte thjesht një dritare, por simbol ngazëllimi e dhimbjeje. Mbeta gjatë duke e vështruar dhe disa nga fëmijët e kopshtit, që ishin në oborr, më shihnin me habi, nuk kuptonin pse ky xhaxhi me mjekër rrinte si i ngrirë, me kokën lart...

Dy ditë nuk e mora veten nga tronditja. Më mirë sikur Flora të më kishte thënë që atë natë kur erdha se edhe akacien e kishin prerë. Po ku e dinte ajo se ç'ishte akacia për mua? I përmbytur nga një dallgë malli gjeta poezinë që kisha shkruar dikur për akacien, e lexova dhe sikur u lehtësova. Mirë që më kishin mbetur të paktën ato vargje për të, të mira a të këqia, pak rëndësi kishte. Se mos do ta botoja poezinë.

Me gjithë dhimbjen që më shkaktoi pamja që më qe shfaqur para syve - mungesa e kopshtit të dashur dhe e akacies - ato ditë pata momente kthjellimi e nisa të shkruaja. Po me shumë zor, gati me dhunë, dhe shumicën e fletëve i hidhja në kosh.

Kur lodhesha së shkruari, e lodhesha kot, se mendja s'më pillte asgjë për të qenë, lexoja. Lexoja me atë shpejtësinë fantastike që më qe shpifur në burg pas traumës që kisha pësuar dhe që kishte lënë pa mend Pirro Angjelin e të tjerët, përveç Bedri Myfitit që kishte thënë se s'kishte asgjë të habitshme: isha bërë tamam si një gazetarë dhe poeteshë e shquar, të cilën ai e kishte pasur kolege dhe e njihte prej vitesh. Më shumë lexoja libra që i kisha në bibliotekën e shtëpisë, po ndonjëherë dilja në qytet e blija ndonjë të ri. Shumica e librave të rinj ishin nga autorë të huaj dhe përherë e më shumë po dilnin në shitje libra që dikur ishin të ndaluar. Blija rrallë e tek, nuk ma mbante xhepi për më shumë, se isha i papunë dhe jetonim vetëm me pensionin e mamasë e me njëfarë ndihme simbolike që më jepte Komiteti i ish-të Përndjekurve Politikë. Kishim dhe ca para që babi i kishte vënë në librezën e kursimit e po ashtu edhe ca të tjera që jaja, para se të vdiste, ia kishte lënë mamasë, por ato i ruanim për ditë të vështira dhe e hiqnim hollë, kështu që me gjithë dëshirën e madhe, pak libra bleva. Ngranjëherë shkoja në bibliotekën e qytetit e lexoja, lexoja një libër brenda gjysmë ore dhe e vija në vend për të marrë

një tjetër, aq sa punonjëset që shërbenin, dy gra të sjellshme, habiteshin me mua, kujtonin se lexoja vetëm faqet e para dhe ngaqë libri nuk më pëlqente, merrja një tjetër.

Një ditë, kur u ndodha vetëm me to, u thashë se i lexoja librat deri në fund dhe isha gati të riprodhoja saktë përmbajtjen e tyre, po nuk më besuan. Më provoni u thashë, por ato këmbyen ca shenja me shoqja-shoqen e më thanë, Një herë tjetër. Nuk donin të më provonin, madje sikur u frikësuan. Si të doni, u thashë. Por ta dini që nuk është defekt, por *funksionim i veçantë i trurit tim*. U thashë fjalët që Bedriu i kishte thënë Pirro Angelit për mua kur ishim në burg.

Njëra nga punonjëset më tha se më njihte, por Ah, sa keni ndryshuar!, tha, dhe ofshajti. Keni qenë ndër gjykatësit më të mirë, keni gjykuar edhe një çështje civile timen. Mua nuk më kujtohej dhe i thashë, Burgu më ka shuar nga mendja shumë gjëra, zonjë e dashur, dhe u ktheva nga rafti i librave, por e ndieja që sytë e saj më ndiqnin me pikëllim. Jo vetëm nuk kishte besuar se lexoja me shpejtësi fantastike, po me siguri kujtonte se burgu më kishte fshirë nga mendja edhe shkronjat. Kush i beson një ish-të burgosuri si unë, kur fjala se vija nga burgu me një dërrasë mangut kishte marrë dhenë?

Në qytet u shmangesha të njohurve, ndërroja rrugë, rrëbythesha ose bëja sikur nuk i shihja, po kur s'kisha nga t'ia mbaja detyroheshja të bëja një copë herë muhabet me të njohurin duke u përpjekur të fshihja çekuilibrin tim, nuk doja ta merrte vesh njeri që nuk isha në rregull nga burgjitë e kjo më torturonte.

Një ditë pashë Jorgjin, ish-vjehrrin tim, ish-Kryetarin e Gjykatës dhe ish-shefin tim, qe plakur e thinjur, po prapë mbahej, i pashëm se i pashëm kishte mbetur. E pashë kur doli me një tjetër nga një klub teksa unë ecja me nxitim me çantën të mbushur me libra në bibliotekë. Nuk pata kohë t'i shmangesha dhe u përballëm.

Më pa si i shushatur e ngriu në vend pa m'i ndarë sytë, si të donte të bindej nëse isha vërtet unë. Ktheva kokën nga ai dhe me një gjysmëbuzëqeshje i thashë, Shoku Jorgji apo zoti Jorgji, si t'ju thërras? Ai sikur u tkurr dhe ktheu fytyrën nga tjetri me njëfarë gjestikulimi vetëmbrojtës. A jeni më shkop në dorën e drejtësisë socialiste, shoku Jorgji, meqë socializmi juaj ende vazhdon me Partinë tuaj të ndritur Socialiste? Viktor, ende te politika e ke mendjen?, ma ktheu me të butë dhe pashë se vështrimi iu err nga brenga. Më kishte dashur shumë, isha i bindur për këtë. Dhe ishte shpirtmadh. Ishte ndër të rrallët njerëz

shpirtmëdhenj që kisha ndeshur në jetë. Pse nuk vjen të të përqafoj?, më tha dhe u nis drejt meje. I bëra shenjë me dorë të mos më afrohej. U ndal në vend dhe pushoi se u përlot. Nuk e kisha parë kurrë të përlotej kur punoja me të, edhe pse kishte shpirt të ndjeshëm. Nuk m'u dhimbs, sepse ende ndodhesha nën furinë e tërbimit dhe të ironisë, duke e llogaritur edhe atë ndër keqbërësit e mi, që s' ishte. Megjithëse tani kemi pluralizëm, vazhdova unë si i ndërkryer, ai dajaku i drejtësisë suaj socialiste ende e godet drejtësinë njerëzore, apo ajo më në fund shpëtoi prej tij?

E kisha rënduar shumë, por nuk bëri kurrfarë vetëmbrojtjeje, vetëm se hapi krahët në shenjë malli a pafuqie dhe më pa në sy me një si ndjenjë pendese, nuk e di. Më vjen vërtet keq për ty, Viktor, më tha. Po edhe ty duhet të të vijë keq për ne. E kishte fjalën për vete dhe për të bijën, Margaritën. Se të kemi dashur, vazhdoi. Kurse ti... Desha t'i thosha se unë vërtet kisha gabuar, por gabimi i tij dhe i së bijës kishte qenë ku e ku më i madh se gabimi im. Sidomos gabimi i tij. Më saktë, i pushtetit që përfaqësonte ai. Sepse calikun e mendjes sime të kthjellët e kishte shpuar thika e mprehtë e diktaturës së tij dhe ai, sigurisht, do të rridhte, do të kullonin prej tij mendime apokrifë, të kundërta me të tija, do të dilnin në shesh e do të dënoheshin. Por nuk i thashë asgjë nga këto. U ktheva e vazhdova rrugën.

Në mars të vitit 1992 u bënë zgjedhjet parlamentare ku morën pjesë disa parti politike. Unë votova për demokratët, të cilët fituan. Lufta politike u zhvillua e ashpër, për herë të parë u përmbys edhe juridikisht një sistem shtypës totalitar. U gëzova që fitoi demokracia liberale. Por kisha bindjen se lufta politike do të vazhdonte e ashpër edhe në të ardhmen, sepse sistemi komunist kishte rrënjë të thella dhe shumë nga ata që hiqeshin për *demokratë* ishin komunistë nën maskën e demokratit, ujq me lëkura qengjash. Uroja të mos rikthehej prapë diktatura e çfarëdo ngjyre, të mos ndryshonte struktura bazë e shtetit, *konstitucioni* i tij, të mos ngrihej më një *partitokraci* e re, të qëndronin shtyllat themelore të shtetit, liritë e individit, prona private, pluripartitizmi, e drejta e besimit fetar e shumë të tjera. Partitë vijnë e ikin, po mos qoftë thënë që partia në fuqi të ndërtonte një sistem të ri diktatorial. Të paktën jo komunist, uroja me vete. As fashizmi nuk i zhduku të gjitha liritë e individit, nuk preku as pronën private

as fenë, dhe lejoi njëfarë dinjiteti të njeriut në poshtërimin total që i bëri atij. Kurse komunizmi e ktheu njeriun në qenien parake duke e atrofizuar fizikisht dhe duke e zhveshur shpirtërisht.

Qëndrova në shtëpi nën kujdesin e mamasë e të Florës, që vinte shpesh të më shihte, derisa një ditë as ilaçet e Abazit, që i pija rregullisht, nuk e ndaluan dot sëmundjen time të shpërthente. Aty nga fundi i qershorit 1992 Abazi erdhi me autoambulancë e më tha se do të më çonte në Tiranë për kontroll. I tha mamasë të mblidhte disa ndërresa të lara për mua, shami hundësh, furçën dhe pastën e dhëmbëve, peshqir, një triko e ca gjëra të tjera dhe e kuptova se nuk ishte fjala thjesht për kontroll, po për t'u shtruar në spital.

Rrija ulur në kolltuk urtë, nuk flisja, shihja mamanë dhe Florën tek bënë ecejake nëpër shtëpi duke mbledhur plaçkat e mia dhe hera-herës kryqëzoja shikimin me mamanë, që i kishte sytë të ujitur, i dridheshin lotët në qerpikë dhe rrudhëzat rreth syve sikur iu shpeshtuan dhe pastaj çdo gjë ishte gati.

Mamaja doli te porta, ku priste ambulanca, më puthi në të dyja faqet, më lagu me lot, kurse unë nuk e putha, se për një çast m'u duk e huaj, e largët dhe e kotë. Për kë kam nevojë unë e kush më qëndron në krah, thashë me vete si idiot, duhej të ishte *Ajo* aty që të më përcillte dhe duket këtë fjalë e thashë me zë dhe mamaja u trondit. Harroje atë, bir, më tha. Nuk pata kohë t'i përgjigjesha, se ndjeva dorën e Abazit të më tërhiqte butë, më hipi në makinë e u ul pranë meje. Donte dhe Flora të hipte pranë meje, por atë e zinte makina dhe Abazi i tha të hipte përpara, me shoferin.

Në kohën që makina po nisej, unë hapa derën, dola jashtë pa u ndier dhe qëndrova në anë të rrugës. As Flora, as Abazi e as shoferi i ambulancës, madje as mamaja, që ende qëndronte përpara portës, duke fshirë sytë me shami, si i kullonin lotët, të shkretës!, nuk thanë gjë, më shihnin e nuk flisnin, dhe unë pashë se si ambulanca largohej pa mua, kurse për mua qe nisur, dhe vazhdova rrugën i qetë drejt pjacës. E kisha vendosur se ku do të shkoja: në fshatin e *Saj*. Të takoja *Atë*, për të cilën më kishte piktisur malli aq shumë, kisha njëmbëdhjetë vjet pa e parë, pa i prekur duart e pa kredhur sytë në sytë e saj. Ah, le të thonë ç'të duan për dashurinë, po unë them se mbi të gjitha ajo është kredhje në sytë e atij që dashuron, ky është çasti më sublim i dashurisë, është porta që hap ëmbëlsinë dhe magjinë e saj, e pastaj vijnë puthjet e përqaftimet dhe marrëzia e seksit e gjithçka tjetër,

lotët dhe kujtimet, dhe kishte kaluar një kohë tmerrësisht e gjatë që kur nuk kisha bërë një kredhje të tillë në sytë e saj.

Shkova te vendi ku rrinte taksia e jevgut, e atij që më kishte çuar edhe herë të tjera në atë fshat të largët buzë Vjosës, afër detit. Ishte në ngjyrë të zezë ajo, por pashë se nuk ndodhej atje dhe vendosa të prisja duke uruar të mos kishte shkuar në ndonjë qytet tjetër, po si zor, se tani njerëzit udhëtonin më shumë me mikrobusë, ose furgona, siç u thoshin tani, megjithëse furgonat, me sa dija unë, janë për mallra, po nejtse, se edhe njerëzit fundja mallra janë, dhe atë kohë desh bërtita nga gëzimi, sepse pashë jevgun, taksixhiun, që ndaloi taksinë, që nuk ishte e zezë, por e verdhë. Ai zbriti nga vetura e nisi të merrej me gomën e parë. Iu afrova dhe mbeta në vend si i goditur nga rrufeja: taksixhiu ishte rinuar në mënyrë të pabesueshme, ishte bërë një djalë njëzet e pesëvjeçar, nga pesëdhjetë e ca që kishte qenë përpara njëmbëdhjetë vjetësh.

Ia ngula sytë e po e shihja i çmeritur, më vuri re e më tha, Doni të shkoni kund, zotëri?, por unë rrija si i ngrirë. Kisha lexuar në përalla se njeriu mund të vdesë e të ngjallet, ose të rrijë përjetësisht i ri, si Fausti, po që të rinohet, të kthehet pas në kohë, këtë nuk e kisha hasur. E pyeta, Ai që ke qenë je, apo gabohem? Nuk më kuptoi, ose kujtoi se i thashë, Me atë taksi je akoma?, dhe m'u përgjigj, Jo, e kam ndërruar, kam blerë një të re, se e vjetra kishte marrë fund. Desha t'i thosha edhe një herë, Mor po a je ai taksixhiu i dikurshëm, jevgu, i vetmi jevg me taksi në qytetin tonë?, por e lashë e i thashë, Dua të shkoj në filan fshat. E dinte se ku binte, hipa dhe u nisëm. Kur mbërritën në Qafën e Koshovicës u kujtova që nuk kisha asnjë lek me vete dhe u tmerrova. Ndale, ulërita. Ndale! Më pa me habi e frenoi, nuk e kuptoi ç'më kishte ndodhur. I shpjegova si ishte puna e më tha me ton të butë, me vështrim të qeshur, Për këtë shqetësoheni, z. Gjykatës? Në s'keni sot, m'i jepni kur t'i keni, se im atë, rahmet pastë, ju respektonte, madje krenohej që kishte një njeri të njohur si ju, ju quante mik, dhe pashë se u përlot. Ah, brita me vete, jevgu nuk paskesh qenë ai i dikurshmi, por i biri, ishte Jevgu i Riu, jo Jevgu Plaku, se plaku kishte vdekur e u ftillova. Më vjen keq, i thashë, ngushëllime, nuk e dija që paska vdekur. Vdiq vjet, tha djali. Dhe zanatin e tij e mora unë. Të të ketë lënë uratën, o bir, i thashë. Edhe bekimin për të bërë pak prokopi, se ai i ziu mezi e përballonte jetën. Pashë se u prek dhe fshiu një pikë lot.

Pas ndonjë ore e ca mbërritëm në fshat dhe me udhëzimet e mia, se djali nuk e njihje fshatin, taksia mori rrugën e njohur, rrugën që të shpinte te kasollja e *Saj*. Sa mirë e njihja atë rrugë, rrugë e qetë fshati, e rrethuar me gjerdhe e plepa dhe, kur zbrita, i thashë djalit të më priste ndonjë orë apo dy. Sa të doni, më tha, ju pres edhe tërë natën, dhe më buzëqeshi me çiltërsi.

Ndalova përpara trinës, gati sa s'm'u ça zemra kur u gjenda atje, aq fort më rrihte. Prisja që *Ajo* të dilte, siç bënte përherë kur dëgjonte zhurmën e taksisë, por heshtje. Bëra të hapja trinën e të hyja në oborr e ndërkohë vura re se shtëpia kishte ndryshuar, qe lyster nga jashtë me gëlqere, dhe kopshti dukej i mirëmbajtur, i mbjellë e i selitur. Edhe qershia ishte dhe u gëzova. Atë kohë doli në oborr një grua, çka më habiti. Edhe ajo u habit kur më pa e më pyeti se kë kërkoja. Ia thashë e më tha, Oh, nuk banojnë më këtu, kanë nja dy vjet që kanë ikur, ka ikur plaka me nipin, se vajza nuk ka ikur, është këtu, në fshat. Ku këtu?, e pyeta me një frymë, gjithë ankth, çmendurisht i gëzuar që *Ajo* nuk kishte ikur, por edhe i hidhëruar që Plaka me Nipin nuk ndodheshin, se doja t'i takoja edhe ata, me mall bile, me shumë mall. Banon atje, më tha gruaja, matanë varrezave, atje e ka shtëpinë. E falënderova dhe u nisa me vrap.

Fshatin e lashë pas dhe ndalova buzë një çeltine me bar, përtej gardhit të varrezave, nën një pishë. Atje ishte një mezhde varri me një kryq druri të pagdhundur e me një rrënjë trëndafil të mbushur me lule të mëdha, të kuqe, të mrekullueshme, që kishin zënë thuajse gjysmën e varrit. Çudi, thashë me vete, një varr jashtë varrezave. Pse kështu? Mos ishte ndonjë që kishte vvarë veten? Ka të ngjarë, thashë, dhe zura të kërkoja me sy se ku mund të ishte shtëpia e *Saj*, ose më saktë kasollja e *Saj*, që nuk e dija pse e kishte ndërruar, por asnjë kasolle nuk më zuri syri. Përtej kullosnin disa lopë dhe një tufë patash shëtitnin nëpër bar.

Vendosa ta thërrisja, se mund të më dëgjonte. M'u ndriçua në mendje emri i *Saj* si i shkruar me zigzage vetëtimash, m'u dritësua në përfytyrim fytyra e *Saj* e magjishme dhe bëra ta thërrisja, po zëri nuk më dilte. O tmerr, si nuk mund të nxirrja një fije zëri? Tamam si në ato ëndrrat e liga, kur as ecën dot, as lëviz dot. Dhe atë çast, o çudi, pashë se ajri u mbush me petale trëndafilash të bardhë që binin si fluturza bore dhe vërtiteshin rreth meje plot gaz dhe pashë se nuk ishin petale të bardha, por fletë të mbushura me poezi... por

poezitë e kujt ishin dhe pse më bëhej se i kisha lexuar?, dhe befas nga qielli zbriti një kopsht i njohur, në të cilin kisha qenë dikur me *Atë*, po ç'donte ai kopsht atje dhe si mund të zbriste nga qielli një kopsht?, pastaj dëgjova oshëtimën e detit dhe në bregun e mbushur me rërë të bardhë, sa çudi, plazhistët ishin statuja të gurta, të kthyera me fytyrë nga deti, dhe unë pashë statujën e hatashme të një vajze adoleshente të zbuluar në Apoloni, e cila lëvizi dhe u kthye nga unë dhe unë pashë se nuk ishte statuja e adoleshentes, por vetë *Ajo*, kurse mua më qe dukur si statujë, dhe ja ku m'u shfaq fytyra e saj e ëmbël dhe rrezëllitëse dhe *Ajo* u derdh drejt meje me klithma gëzimi dhe unë u sula drejt saj dhe në kohën që u afruam e do të përqafoheshim dëgjova një zë të njohur, dashamirës e të butë, që më foli nga pas, dhe unë ktheva kryet dhe pashë figurën e Florës të vizatuar në horizont, pastaj ktheva kokën me vrik nga *Ajo* dhe pashë se *Ajo* nuk ndodhej më përpara meje dhe unë u tmerrova dhe i thirra, E dashur, pse ike? Zemër, qendro! Ku je, shpirt? Pse s'po të shoh? Prit, të lutem!, dhe pastaj, i dëshpëruar në kulm, i inatosur me Florën, i ulërita, Pse më ndoqe? Ç'punë kishe të më vije pas? Ti s'më ke përgjuar kurrë!, por Flora, e bërë dyllë, më fërkonte ballin me një shami të lagur, kurse Abazi po bënte gati një gjilpërë për të ma ngulur, po duket ndërroi mendje se e dëgjova që tha, Po e lë, se po qetësohet.

-Ndalojmë pak këtu? - e pyeti Flora duke treguar me dorë një klub në anë të rrugës. - Sa të qetësohet mirë.

-Patjetër, - tha Abazi dhe zbriti.

Flora deshi të më ndihmonte të zbrisja, por ia largova dorën me inat. Zbrita pa ndihmën e saj dhe pashë tabelën e klubit që lexonte: PILO LALA.

Mbërritëm në Tiranë aty nga dreka dhe u desh të kalonte një kohë e gjatë derisa erdhi doktori *i duhur* për të më vizituar mua. Burrë i pashëm ishte, me flokë të bardhë të dendur, i ngjante shumë Kristaq Shtëmbarit, një miku tim, vetëm se Kristaqi i kishte flokët skrop të zinj.

Doktori më futi në klinikë dhe bisedoi rreth gjysmë ore me Abazin e pastaj nisi të më pyeste mua, më kontrollloi me ca drita e më goditi nëpër gjymtyrë me një çekiç gome, më bëri kontrolle edhe me ca aparatura si televizorë e më tha se kontrollet do të vazhdonin edhe në ditët e ardhme. Më tha se më duhej të rrija për disa ditë në

spital, nën kontrollin e tij, që ta merrja veten mirë. Në fund fare u prezantua, tha se quhej Idriz Hysa dhe kishte kënaqësi të më quante jo pacientin e tij, por shokun e tij. Bukur, thashë me vete, m'ua shtua edhe një shok tjetër mjek.

Më çuan në një dhomë të pastër, të mobiluar thjesht, një krevat, një komodinë e një lavaman. Goxha mirë, thashë për lavamanin, nuk do të shkoja të laja dhëmbët në çesmat e përbashkëta, si në burg, ku shpesh nuk gjeja radhë tek ai tubi me vrima që quhej çesmë.

Flora më shihte me pikëllim e përpiquej të ishte e qeshur për të më dhënë zemër dhe, kur erdhi koha të ikte, m'ua var në qafë dhe nuk duroi dot më - ia shkrepiti të qarit dhe nuk lëvizte, derisa e tërhoqi Abazi nga dora dhe ajo u shkëput. Abazi më dha dorën e më tha se herë pas here do të vinte tek unë, po mjek më të mirë se Hysa nuk gjendej, ai do vinte thjesht për vizitë si shok, jo si mjek.

Qëndroja në mesore, te dera e dhomës sime, ku kaloi një pacient me uniformë spitali që seç thoshte me vete gjithë gjeste, dhe unë ndiqja Florën me sy teksa largohej me kokën të ulur, dhe e merrja me mend se lotët e saj rignonin në pllakat e pastra akull të mesores dhe pastaj u zhduk prapa qoshes.

U ktheva në dhomë dhe pashë nga dritarja. Përpara meje hapej një korie me pisha nëpër të cilat lëvrinin njerëz, pashë edhe grumbuj e stiva me rroba, mallra e sende të ndryshme të përhapura gjithandej, deri larg në fushë, vinin e iknin makina, shkarkonin e ngarkonin mallra. Një infermiere më tha se ishte fusha e *begsave*, ku ndodhej tregu me shumicë. Pasdite vonë zhurmat u fashitën dhe unë u ndjeva i vetmuar, nuk di pse më kishin pëlqyer ato zhurma dhe doja të vazhdonin.

Kontrollet mjekësore vazhduan për disa ditë. Dr. Hysa më mori në klinikën e tij dhe bëri një bisedë të gjatë me mua, më pyeti për të kaluarën time përpara burgut dhe në burg, ku u ndal më gjatë, më pyeti dhe për atë vit që kisha kaluar në shtëpi pas daljes nga burgu. U interesua sidomos nëse kisha pësuar ndonjë ngjarje tronditëse në burg dhe unë i thashë, E gjithë jeta në burg është një ngjarje tronditëse, por ai nguli këmbë në diçka më specifike. E kuptova ku rrihte, do të kishte marrë vesh për krimin tim dhe tani donte që t'ia pohoja vetë. Po nuk ia pohova, i pohova vetëm ngjarjen kur kisha dashur të hipja mbi gardhin e telave me gjemba që të më vriste ushtari, gjë që i bëri përshtypje. Tjetër, më tha, ndonjë ngjarje

tjetër? Po ja, kur vdiq një miku im, një njeri i Madh, atë Pali, u trondita shumë. Dakord, po ndonjë gjë tjetër? Hë, sa di ti, o doktor!, thashë me vete, po as unë nuk jam budalla. Do që të pohoj krimin, të marrësh në telefon policinë dhe të vijnë policët, të më hedhin prangat, dhe të më çojnë prapë në atë burg të llahtarshëm?

Po, ja i thashë, një ditë ndodhi një shembje në galeri, dhëu më zuri poshtë e u tmerrova. Siç e shihni, nuk vdiqa, u vrava pak, po vetëm kaq, doktori i burgut tha se kisha qenë me fat që nuk më qe këputur ndonjë krah a këmbë. Pashë se kjo që i tregova i bëri përshtypje. Ndonjë gjë tjetër? më pyeti. Hë, sa këmbëngulës qenke!, thashë me vete dhe prapë i bishtnova. Me siguri do të ishte ekspert edhe në kriminalogji. Po ja, shkruaja fshehtas ca shënime, *ese*, siç i thonë ndryshe, që ishin kundër diktaturës dhe kisha frikë mos më kapnin policët, m'i gjenin e më dënonin prapë. Siç më kishin dënuar në vitin 1980, kur më kishin gjetur ca shënime të ngjashme me to. Në rregull, tha, dhe nuk më bëri më pyetje të tjera. I japim fund për sot. Çka do të thoshte se prapë do të më pyeste për ndonjë ngjarje tronditëse në burg. Pyetëm sa të duash, thashë me vete, krimin nuk e tregoj.

Kështu, u bëra pacient i rregullt i Dr. Hysës, bisedat me të nuk kishin fund dhe një ditë, në një çast lëshimi, që nuk e di nga dreqin më erdhi, ndoshta nga bindja se Dr. Hysa e dinte krimin tim dhe më kot e mundoja duke e detyruar të më bënte pyetje pa pushim, ia pohova. Po, doktor, i thashë, më ka ndodhur edhe një ngjarje tjetër tronditëse. Kam vrarë një njeri.

Ai mbeti pa frymë nga habia. Me hetoi mirë e mirë a flisja seriozisht, apo ishte një mendim delirant që e fantazoja.

-E vrava sa i luajta fenë. E kishte hak.

-Ku, në burg?

-Jo, jo në burg, - dredhova në çast. - Kush vret dot në burg? Policët atje janë të aftë zbulojnë kush është fajtor në një grindje të thjeshtë, jo më një krim. Jo, nuk e kam bërë në burg.

-Po ku?

-Atë e di vetëm unë dhe Zoti, po qe se ka Zot. Po qe se jo, aq më mirë, nuk kam asnjë dëshmitar.

Nuk i thashë se të vetmit njeri që ia kisha treguar krimin kishte qenë atë Pali, sepse ky rrëfim do të zbulonte vendin e krimit, çka ishte njësoj e rrezikshme.

-Kë ke vrarë?

-Një që e kishte hak. Jua thashë një herë, doktor.

-Të paktën më thoni kohën kur e keni bërë, para burgut, në burg a pas burgut.

-Nuk e tregoj. Boll që ju thashë se kam bërë një krim dhe besoj se kjo mjafton.

-Nuk mjafton. Do të doja të dija më shumë hollësi që të merrja vesh diçka më mirë për turbullimin tuaj dhe për mjekimin tuaj.

-Ah! Po ligji nuk hyn fare në këtë mes? I zgjuar jeni, doktor, për besë!

Ai nuk e prishi terezinë.

-Unë jam mjek, nuk jam as jurist e as polic. Mua më intereson tronditja juaj për shkak të atij krimi.

-E di si është puna, doktor? Unë nuk kam bërë kurrfarë krimi, gjithçka që ju thashë ishte fantazi. Unë kam qenë jurist dhe e kam pasur për detyrë t'i dënoja krimet, jo t'i bëja vetë.

Dr. Hysa qëndroi një hop në mëdyshje, i ngarritur të fliste, pa qenë i sigurt nëse kisha bërë vërtet ndonjë vrasje apo jo.

-Në rregull, i japim fund për sot, - më tha. - Do të vazhdojmë më vonë. Në rastin tuaj bisedat janë ndër mjekimet më të mira, në mos më i miri. Ilaçet i pini rregullisht?

E kishte fjalën për një grusht tabletash që pija çdo ditë.

-Po. Ku ikën infermierja pa më parë që i pi të gjitha?

-Bukur. Mund të shkoni.

-Desha t'ju thosha edhe diçka, doktor, mundem?

-Posi jo?

-Pas asaj shembjes për të cilën ju fola, tek unë ndodhi një ndryshim i habitshëm në mënyrën e të lexuarit, lexoj me shpejtësi fantastike.

-Si kështu? - tha pa ma varur fare, duke shkruar diçka në kartelë.

-Ja që kështu. E lexoj një libër mesatar prej 300 faqesh për 25-30 minuta.

Ngriti sytë e më pa. Kujtoja se do të interesohej për atë çudi, siç qenë interesuar shokët e mi të burgut, por ai, me ç'pashë, nuk i kushtoi rëndësi. Megjithatë, më pyeti:

-Kështu keni lexuar përherë?

-Jo. M'u shfaq pas asaj shembjes në galeri.

Pashë se një buzët e tij lëvriu një buzëqeshje mosbesimi, si ajo

hardhucka që del nga vrima e murit për një çast dhe futet prapë në të me shpejtësi. E kuptova - kujtoi se ishte një halucinacion imi, domethënë një dukuri normale për një pacient si unë, ndaj më hipën nervat.

-Mund të bëni një provë. Mund t'ju hyjë në punë për mjekimin tim.

Pashë se sikur nuk i erdhi mirë që kisha ndërhyrë në punën e tij. I dha fund të shkruarit, u ngrit nga tryeza, më rrahu supin miqësisht e më tha:

-S'është nevoja për prova të tilla. Edhe po qe se lexoni aq shpejt, kjo s'ka të bëjë me turbullimn tuaj. Që lexoni, bëni mirë, po mos u lodhni shumë. Sa të qetësoheni, pastaj mund të lexoni sa të doni.

E ndjeva veten të fyer, nuk më kishte besuar.

-S'doni të bëjmë një provë?

-Them se s'është nevoja. Megjithatë, po qe se ngulni këmbë, e bëjmë, po jo sot.

Më tërhoqi butë nga krahu dhe më shoqëroi deri te dera e dhomës sime, më përshëndeti e u largua. Provën nuk ma bëri asnjëherë dhe unë nuk e ngava më atë muhabet.

Të gjithë librat që më kishte sjellë Flora i kisha lexuar, po ngaqë nuk kisha të tjerë, i lexoja prapë e prapë, duke u munduar t'i lexoja sa më ngadalë. Në spital kishte dhe njëfarë biblioteke, ku shkova një ditë e u hodha një sy titujve. Nuk ishin libra për të qenë dhe nuk mora asnjë për të lexuar. Pas një muaji Flora më solli ca libra të rinj dhe u gëzova shumë.

-Tori, - më tha si me turp, - e kuptoj dëshirën tënde për të lexuar, po jemi pak si hollë... Ti e di, mamaja pensionin ka, rroga ime dhe e Nardit mezi na del se kemi dhe fëmijët, dhe më kupto, librat janë shumë të shtrenjtë...

Edhe pse me ardhjen e demokracisë Florën e kishin marrë përsëri në teatër, rolet e saj tashmë ishin të rralla, nuk luante më role vajzash të reja punëtoresh, studente apo aksioniste, që bënin dashuri *socialiste*, po rolin e ndonjë nëne a gjysheje. Le që dhe pjesët teatrale tani qenë rralluar; një vënie në skenë, tha Flora, kushtonte shumë më tepër nga ç'fitohej nga biletat. Njerëzit, sidomos të rinjtë, as që e kishin mendjen te teatri, kishin halle të tjera, merreshin me biznese ose luftonin të gjenin viza për të shkuar në Perëndim për të punuar.

Për disa ditë pas ikjes së Florës pata turbullime të vazhduara,

flisja me vete, më shfaqeshin figura të frikshme dhe njëherë m' u bë se ai që kisha vrarë u ngrit nga poshtë pirgut të gurëve dhe ndonëse që bërë skelet, e njoha që ishte ai, m' u vërsul të më sfokte me krahët e tij kockorë që edhe pse pa muskuj, lëviznin normalisht, dhe më shikonte me sy fosforeshentë, domethënë me zgavrat e syve, athua se brenda tyre ishin ndezur dy llambushka.

Dola nga dhoma i tmerruar e duke i bërtitur, Ik, zhduku, e pate hak që ta bëra ashtu!, po ai vazhdonte të më ndiqte e megjithëse në mesore u ndodhën dy infermiere, edhe sanitarja me shtupë, madje dhe dy mjekë, Hysa nuk ishte, u mbloodhën dhe disa pacientë, skeleti nuk donte t'ia dinte për ta dhe pastaj nuk mbaj mend ç'ndodhi, se kush që ai që më kapi nga duart, nga supet, më shtrënguan edhe duar të tjera e më çuan në dhomën time, ku ndjeva dy a tri pickime gjilpërash dhe humba në gjumë.

Pas ca ditësh e mora veten dhe për ca kohë nuk m' u shfaqën më vegime. Në një nga ato ditë më erdhi për vizitë Pirro Angjeli, inxhinieri i ndërtimeve civile, ai njeri i rrallë që më kishte dashur si vëlla në burg dhe, për fat të mirë, isha i kthjellët. Qëndroi ndonjë orë, më solli plot ushqime. Kot i solle, i thashë, se këtu ushqimi është më i mirë se në burg. Më sjellin dhe nga shtëpia, i thashë, por e gënjeva – se kush ishte shtëpia ime hollë-hollë veç mamasë? Flora kishte shtëpinë e saj, fëmijët e saj, hallet e saj.

Ditët e fundit në burg Pirroja më kishte thënë se kur të lirohej do të shkonte në Amerikë me gjithë familjen, po tani kishte ndërruar mendje. Qysh kur dola nga burgu, më tha, u bëra demokrat dhe me ardhjen e demokratëve në pushtet më janë krijuar mundësi për të hapur një firmë ndërtimi. U gëzova shumë e i urova suksese.

-Për çfarë ke nevojë? - më pyeti. - Ma thuaj hapur, si vëlla.

-Për ndonjë libër, o Pirro. Filozofik, historik ose sociologjik. Ndonjë për lirinë dhe të drejtën.

-Do shoh nëpër librari, - më tha. - Po dalin shumë libra, s'janë më të ndaluar. Artistikë nuk do? Në burg lexoje...

-Jo se nuk dua, o Pirro, po...

-Po çfarë?

-Nuk i blej dot. Jam një çikë hollë... - shtova si me turp.

-Do t' i blej unë dhe do të t' i sjell peshqesh, - më tha. - Tani për tani edhe unë jam pak hollë, po shpresoj ta marr veten. Kam ca plane me një mik, që po na dolën, do të jetë mrekulli.

E përçolla deri në fund të mesores, te dera tjetër që të nxirrte në hollin e madh. U përqaftuam e u puthëm.

Pas ca kohe Pirroja më solli një pako të madhe me libra në anglisht, shumica filozofikë. Më tha se i kishte porositur në Amerikë, ku kishte rrënjë të vjetra. Ndër to ishin: *Mbi Lirinë* e Millit, *Ç'është Liria?* e Arendtit, *Katër Ese mbi Lirinë* e Berlinit, *Filozofia e së Drejtës* e Hegelit, *Letra të Shkruara nga Mali* e Rusoit, *Kritika e Arsyes* e Kantit, *Filozofia Antike Greke* e Skotit dhe një libër për filozofinë e Lindjes së Lashtë. Artistikë ishin romanet *Përrallë* i Foknerit dhe *Si ia Kalove Sot?* i Bellout, të dy nobelistë. U habita.

-Po ti më ke sjellë një librari të tërë!

-Ç'ke ti. Më vonë do të të sjell prapë.

-Po munde, o Pirro, edhe Fjalorin e Gjuhës Shqipe, duhet të jetë në treg. Ka fjalë që nuk ua di kuptimin.

-Po, ma kanë zënë sytë.

Më kishte sjellë edhe ushqime, një qese me sallam, një kavanoz mjaltë, djathë kaçkavall e ca konserva peshku.

Me të ikur Pirroja iu futua leximit të librave dhe për dy javë i mbarova. Atë për filozofët e lashtë grekë e lexova disa herë dhe më pëlqeu pa masë. Edhe ai që bënte fjalë për rrymat filozofike të Lindjes, në Kinë e Indi, më pëlqeu. Megjithatë, edhe pse filozofia e lashtë indiane më intrigoj, filozofët grekë prapë mbetën më të dashurit për mua. Mbase ngaqë nuk ishin anonimë, si shumica e filozofëve lindorë, kishin emra e biografi, madje dhe hollësi nga jeta e tyre. Një nga librat kishte edhe fotografitë e busteve të tyre. Më pëlqeu sidomos portreti i Zenonit dhe kur Pirroja erdhi prapë iu luta që po të kishte mundësi të shkonte te një fotograf e ta zmadhonte.

-Pse pikërisht atë? - më pyeti.

-Duket që është burrë i mençur. Më kujton babanë. Të mbaj në murin e spitalit fotografinë e babait nuk shkon. Ajo e një filozofi ka lezet.

Megjithëse edhe im atë kishte qenë një lloj filozofi në thjeshtësinë e tij, s'kishte bërë emër në histori. I dhashë Pirros librin me portretet e filozofëve grekë e pas nja dy javësh më solli një fotografi të zmadhuar të Zenonit, që e vura në mur, kundruall krevatit. Më solli edhe një televizor të vogël dhe u kënaqa, mund të shihja ndonjë film a të ndiqja lajmet i shtrirë në krevat, pa qenë i detyruar të shkoja te salla e madhe, ku në shumicën e rasteve pacientët ziheshin për

kanalin ku donin ta mbanin, madje njeri kishte nxjerrë palloshin dhe kishte bërë shurrën drejt e në ekran.

Kështu kaloi viti i parë në spital, me turbullime, kthjellime e lexime librash, me kontrolle mjekësore, me një grusht tabletash tri herë në ditë, me vizitorë të rrallë, nja dy herë më erdhi edhe mamaja, po atë e lodhte udhëtimi e i thashë të mos vinte më, kurse Flora më erdhi më shpesh, dy herë me Nardin, dhe vizitori i përhershëm ishte Pirroja.

Ndërkohë, luftimet në ish-Jugosllavi, sidomos në Bosnje e Kroaci, ku vriteshin njerëz të pafajshëm e varroseshin në varre masive, më tronditnin thellë. Vetëm në Bosnje numri i të vrarëve kishte arritur mbi një çerek milion. Tmerr! Ishte lufta më e përgjakshme që nga Lufta e Dytë Botërore. Mendja më prodhonte përsiatje e m'u bë prapë fiksim të shkruaja refleksione si në burg, por nuk isha në gjendje t'i hidhja në letër, kështu që i shkruaja me mend. Ç'është lufta? titullova një ese. A është çmenduri kolektive, siç thoshte Niçja? Ai thoshte se çmenduria është diçka e rrallë tek individët, kurse te grupet, partitë, popujt dhe epokat është rregull. Por a bëhet vërtet për hir të interesave të gjithëmbarshme etnike e kombëtare?! A nxitet nga pasione etosesh¹ nativiste² dhe kulturash të ndryshme, apo nga synime më të thella për ndryshime gjeopolitike? Ka më fort të ngjarë të jetë kjo e dyta, thosha. A niset nga ndonjë patos etnik i përgjithshëm, apo nga egocentrizmi i një klani pseudopërfaqësuesish të një tërësie etnike? Edhe për këtë pyetje mendoja se kjo e dyta ishte arsyeja. Etnitë kanë bashkëjetuar në shekuj në paqe, kanë marrë e dhënë me njëra-tjetrën, shpesh janë motëruar e madje shkrirë në një. Por, për fat të keq, kjo harmoni jo rrallë është prishur për shkak të interesave të thella të klaneve nën petkun e etosit dhe të genosit. Lufta është pasojë e manisë së prijesve për pushtet, fshehja e saj pas idealeve të lirisë, pas përparësisë së një feje apo etnie ndaj feve dhe etnive të tjera, është gjaku i derdhur për të vaditur lumturinë e babëzitur të më fuqishmëve. Këta demagogë të pështirë i japin luftës etiketa të ndritshme duke futur nën dhé miliona të rinj, por humusi i vaditur me gjak pjell hakmarrje të reja duke i ushqyer njeriut përjetësisht atë kafshëz të egër brenda tij...

1 shpirti karakteristik i një bashkësie, populli ose sistemi

2 politikë sociologjike që përkrah interesat e vendasve kundrejt të ardhurve

Më pas Pirroja më solli *Vedat*¹ e Indisë së Lashtë në anglisht, 4 libra. Mësova se *veda* do të thotë *dije e shenjtë* e megjithëse asokohe më bëhej se isha Demiurgu² Filozof, prapëseprapë në rrokjen e kozmosit isha në errësirë, por besoja se duke lexuar do të kapja diçka nga misteri i tij. Universin e mendoja si një sfinks që fillon nga galaktika më e madhe deri te grimca më e vogël. Zhytesha në vramendje dhe kërkoja të dija ç'ishte e Vërteta Absolute, ose Shpirti i Botës, i cili e rrok krejt Gjithësinë, por, si një pjesëz e Gjithësisë që isha, unë nuk mund ta kapja dot të tërën. Sepse aq aftësi më kishte dhuruar Hyji i Përbotshëm dhe falë këtyre aftësive mund të zbuloja vetëm një pjesë të Ndërgjegjes së saj pa qenë e mundur të kaloja tej caktit të natyrshëm dhe të sfidoja Zanafillën prej nga buronte destini im. Se, a mund të eksplorojë pjesa të tërën, aq më tepër kur kjo *e tërë* është e pafund?

Mjeti im i vetëm ishte fantazia, ajo ecte më shpejt se drita dhe shkonte më larg se ajo, arrinte yllin më të fundit të galaktikës më të fundit, po ç'kishte përtej saj? As fantazia nuk arrinte ta përshkonte Kozmosin dhe do të isha i lumtur sikur ajo të më pajiste me aq dije sa kishte bërë rrugë.

Një natë, ose më saktë një mëngjes, afër agsholit, më pllakosën ca përsiatje për filozofët. Cili filozof, mendoja, nuk rend për të Vërtetën si për Bukuroshen e Fjetur, të mbyllur në kështjellë, e cila rri në pritje të Princit të saj që do ta puthë e ta zgjojë? Ai do të luftonte për të, do të futej në duel me pishollën e tij filozofike nga e cila do të zbrazte saçme idesh të derdhura prej kohësh që nuk mbahen mend, do të përleshej me rivalët dhe kur fishekët t'i mbaroheshin do të kërkonte litarin e sofizmave për të zbritur shkëmbenjtë bashkë me Princeshë/të Vërtetën e tij që do të ishte e vërtetë për të, por hije për të tjerët. Të mjerët filozofë ëndërrtarë... Një natë tjetër demoni im i brendshëm, ai i miri, si i Sokratit, më pyeti ç'më duhej të kërkoja të Vërtetën kur mund të jetoja fare mirë edhe pa të. Dua, iu përgjigja, se nga analogjitë e përbotshme mund të arrij të përftoj një ide se pse, pas një Luftë aq fisnike, në të cilën u derdh gjak i pastër, lindi totalitarizmi si në botë, edhe në vendin tim, pse lindi një përbindsh si Diktatori ynë që i nxu jetën një populli të tërë? A lind *Shpirti i Botës* përbindsha? Kush i pjell

1 libra me shkrime të shenjta të shkruara në gjuhën sanskrite në Indinë e Lashtë
2 krijuesi i botës (sipas Platonit); Zoti; faktorët pjesëmarrës në krijim

vallë? E parëndësishme është të duash të dish të Vërtetën për një arsye të tillë?

Një ditë, në drekë, më ndodhi diçka e habitshme. Sapo kisha lexuar një libër për stoicizmin, që për mendimin tim është rryma e parë filozofike serioze e Greqisë së Lashtë, e themeluar nga Zenoni e Kleanthi dhe e vazhduar nga Krizipi e të tjerë duke pushtuar edhe Romën. Sa pashë sanitaren duke më sjellë drekën në tabaka, u zhduka. Nuk e di pse më bënin privilegj, mbase ngaqë kisha qenë i burgosur politik, ma sillnin ushqimin në dhomë. Sanitarja nuk e vuri re zhdukjen time, çka më habiti, sepse kur ajo nuk kishte dalë nga dhoma, unë nuk ndodhesha në të.

U gjenda në Athinë afër drekës, në një ditë të bukur shtatori të mbytur në një pluhurnajë diellore, ku natyra e peizazhi athinas shkëlqenin me tërë bukurinë e madhështinë e tyre dhe malet Parnas, Pentel dhe Imitos mbanin ende mbi supe mantelet e gjelbra me ndonjë pllangerë verdhane aty-këtu. Athina e Lashtë më la pa mend me bukurinë e saj, sidomos me mrekullinë e Akropolit mbi të cilin ngrihej Partenoni madhështor, tempulli i virgjëreshës Athina, mbrojtëses së qytetit, por më pëlqyen edhe rrugët qendrore, të pastra, të shtruara me kalldrëm, me ndërtesat e bukura e me tempujt e shumtë me kolona, shtëpitë e ulëta, të fshehura mes kopshtiesh të blerta.

Çapa gjer në agora¹ dhe hodha sytë përqark. Sheshi ziente nga gjallëria, mbushur rreth e qark me dyqane, qoshqe e tezga ku shiteshin llojloj gjërash - vazo, qypa, rroba të leshta e të mëndafshta, fruta e zarzavate, zbukurime terrakote, mish i sapotherur, vezë e lule të freskëta. Në një cep pashë një qoshkë e iu afrova. Një bankier shkëmbente monedha të huaja me monedhë vendase, pranë banakut qëndronin dy a tri aziatikë.

Më tej më zuri syri një platformë si ndonjë metër të lartë nga toka ku gjendeshin katër-pesë skillever për t'u shitur, të gjithë gjysmë të zhveshur që t'u dukeshin më mirë muskujt. Nuk di pse m'u dhimbsën ato qenie njerëzore të panjohura dhe ktheva shikimin nga një ndërtesë dykatëshe me kolona, me ballkone të bukura, ku disa gra e vajza soditnin tregun.

Më pickoi hundën një erë e mirë qoftesh të skarës dhe mpreha

¹ pazari, sheshi i tregut në Greqinë e Lashtë

shikimin: në një qoshe të agorasë ishte një stendë me çati të sheshhtë dërrase të mbajtur në katër shtylla druri. Piqeshin qofte e bërçolla në gaca qymyri dhe nxitova për atje. Por sa hodha dy hapa, u ndala, se nuk kisha asnjë monedhë vendase. Uria po më gërryente, po si t'ia bëja? Vrisja mendjen më kot, nuk gjeja zgjidhje.

Diku në anë të sheshit pashë një karro të mbushur cip më cip me fuçi, mbase me ullinj. Iu afrova e qëndrova mënjanë. Një burrë i ngjallur doli nga dyqani e se ç'bisdoi me karrocierin. Ky se ç'i tha dhe burri, duket i zoti i dyqanit, hodhi sytë nga tregu i skllëvërve dhe u nis për atje. Me siguri do të kërkonte të merrte dy-tre syresh me qira për të shkarkuar karron. I dola përpara dhe e ndala, e pyeta nëse kishte nevojë për ndonjë punëtor shkarkimi. Më pa nga sytë këmbët dhe e kuptova që nuk ia mbusha synë, po duket i erdhi keq e më tha ta prisja, e kuptoi që doja të fitoja ndonjë kacidhe. Pas pak u kthye me dy skllëvër të fuqishëm të moshës sime kur isha futur në burg.

Më vetëtiu në mendje galeria e përbindshme në barkun e malit, po s'ishte koha për meditime dhe bashkë me skllëvërit ia nisëm punës gjyrykthi. Skllëvërit kujdeseshin për mua dhe unë zëre se punoja, pasi nuk më linin. Për pak minuta shkarkuam taliken e i futëm fuçitë në dyqan. Pronari në fillim më pagoi mua, më mbushi një dorë me dhrahmi, pastaj shkoi të paguante të zotët e skllëvërve.

I kënaqur, u drejtova nga qoshku i qofteve dhe u denda duke ngrënë bukë elbi me qofte të ngrohta, që më shijuan sa s'bëhet. Ndërkohë kërkoja me sy ndonjë njeri me pamje intelektual që mund ta njihnte Zenonin e Sitiumit ose të paktën të kishte dëgjuar për të. Por nga veshja nuk i dalloje lehtë grekët e vjetër se kush ishte i ditur e kush jo, mund të dalloje se kush ishte i pasur e kush jo, se ndodh që të diturit vishen më keq se të varfrit. Megjithatë, ndala një burrë thujse të moshës sime dhe e pyeta mos vallë e njihnte Zenonin e Sitiumit. Oh, m'u përgjigj burri, kush nuk e njej mësuesin e mençur fenikas? Shumë prindër i çojnë djemtë në Stoan e tij, ndonëse është ca i lajthitur dhe ka ca ide të çuditshme. Edhe unë e çova djalin për ca kohë tek ai, po më pas e hoqa.

Ai uli zërin e shtoi:

-Se është dhe qejfli i grave. Kjo edukatë nuk më pëlqen, megjithëse djemtë i mëson drejt, me sjellje të mira, po kisha frikë se im bir mund të merrte ca huqe prej tij.

Më bënë përshtypje fjalët e çiltra të burrit të panjohur dhe e ftova të pinim nga një kupë verë në një tavernë aty pranë. U ulëm në një tryezë dhogash e u njohëm. I thashë se vija nga Iliria. E njihte atë vend, kishte qenë ushtar në rini andej nga veriu, dmth në jug të Ilirisë, dhe ruante kujtime të bukura. Më foli ca për to, pastaj e pyeta prapë për Zenonin, ç' mund të më thoshte tjetër për të.

-Si njeri është i shkëlqyer - tha. - Dhe me dije të thella. U mëson djemve gjëra praktike, sidomos tregtinë, që e njeh mirë. Pi shumë verë, po nuk del kurrë i dehur. Ka pasur një mësues të rreptë, Kratin, që ia hoqi sqimën, sidomos në të veshur, se pispillosej si femrat. Tani e sheh edhe me zhele, ndonëse mbahet pastër. Po ka atë xanxën që të thashë, ka qejf gratë e bukura, nuk di sa e quani xanxë ju andej, se vini nga tjetër vend.

Hajde llaf, thashë me vete. E kush nuk i ka qejf? Madje figura e Zenonit sikur u lartësua në sytë e mi. I porsanjohuri vazhdoi:

-Shumë nga miqtë i janë larguar, se u thotë, Po më pëlqeu gruaja jote do ta palloj, mos të kemi llafe. Dhe ty, po të pëlqeu gruaja ime, merre e bëj qejf. Nuk është i martuar, me sa duket as ka ndërmend, me gratë e miqve nuk shkon, vetëm sa i tremb e i ngacmon. Ka dashnore gra nga të areopagasve, i shkojnë pas vetës, është i pashëm e i gojës. Shkruan dhe shumë. Ka një shërbëtores të bukur dhe drekat e darkat që shtron janë ndër më të dëgjuarat në Athinë. Fiton shumë, se prindërit e paguajnë mirë për mësimet që u jep djemve, po merret edhe me tregti, e ka në gjak, i vijjnë mallra nga Lindja, tapete, erëza e plot gjëra të tjera që ia shesin administratorët.

Pagova për verën, u ngritëm e dolëm. Burri më tregoi rrugën që të çonte te *Stoa Poikileja* e Zenonit. Mbi agora e ke, më tha, dy çapa larg, merr rrugën majtas, kalo përgjatë *Teseionit* dhe *Buleteurionit* e do dalësh te stoa e tij, është me bojëra ajo.

E falënderova dhe u ndamë. Pas pak u gjenda te shkolla e Zenonit, hyra në oborr e mbajta hapat. Ishte një ndërtesë e gjatë njëkatëshe me kolona të pikturuara me ngjyra të ndezura nën hajatin e së cilës ndodheshin një sërë bankash prej druri ku rrinin ulur djem të moshave të ndryshme, me rrotulla papirusi të hapura përpara vetes. Zenoni ecte përgjatë hajatit, zhdukej për një grimë pas një kolone e shfaqej sërish. E kundroja më nge, duhej të ishte më i ri se unë, te të dyzetat, i veshur me një tunikë bojëhiri, një bluzë me ngjyra sipër saj dhe në

duar mbante një rrotull papirusi. Qëndrova pas një kolone, kisha qejf të dëgjoja zërin e tij e hëpërhë nuk doja të më shihte.

Zenoni shpjegonte përpara klasës.

-Si futet natyra te njeriu? - bëri një pyetje retorike e vazhdoi: - Drita e diellit është zemra jonë, e pastër dhe e ndritshme, por edhe kur ka re ne prapë shohim sa të mos bëjmë gjëra të verbra, dhe kur ka vetëtima prapë shohim dhe kuptojmë grimcën e çastit të arsyes dhe nëse vetëtima godet, kuptojmë se ne nuk duhet të godasim ligsht e verbërisht si ajo dhe, duke e ditur këtë, u shmangemi verbërive të natyrës që është e papërsosur në përsosmërinë e logosit të saj, dhe kur drita e yjeve na ndriçon në verbërinë e netëve të shpirtit tonë dhe në netët e turbullirave apo të luftërave, ne orientohemi nga yjet që kemi brenda nesh sa të dalë dielli i paqes. Natyra është jashtë nesh dhe brenda nesh... Sa më mirë ta lexojmë natyrën, aq më mirë do ta kuptojmë e do ta shkruajmë atë brenda vetes sonë.

Nxënësit e dëgjonin si të hipnotizuar, aq ëmbël tingëllonte zëri i Zenonit.

U largova nga kolona dhe u afrova ngadalë. Zenoni ishte me shpinë nga unë dhe nuk më pa. Disa nga nxënësit ngritën kokat e po më vështronin me kureshtje. Zenoni shkoi gjer në fund të hajatit, te nxënësi i fundit, u përkul mbi të, hodhi shikimim mbi papirusin e tij, diçka i tha e u kthye për këtej. Atë çast më pa, qëndroi një grimë me sytë nga unë si të donte të verifikonte a mos isha prindi i ndonjë nxënësi, po si nuk më njohu, m'u afrua.

E kundrova me vëmendje, ishte një burrë i hijshëm, zeshkan, flokëdrudhë, me sy inteligjentë e të gjallë, me një fytyrë gjatoshë me një mjekër të zezë të lënë si ndonjë gisht të gjatë, që i shkante. Vinte i hollë e i gjatë, por me trup muskuloz. I thashë se isha një dasha-mirës i dijes nga Iliria, kisha dëgjuar për të dhe kisha dëshirë ta njihja nga afër. U gëzua pa masë, më dha dorën, madje më përqafoi, u prek shumë që kisha ardhur nga aq larg për ta takuar. Më tha të prisja një minutë, u kthye nga nxënësit, u tha se mësimi për sot mbaroi dhe djemtë u ngritën gjithë gaz duke mbledhur librat e duke i futur nëpër çantat e tyre ca prej leshi ngjyra-ngjyra e ca prej liri.

Nxënësit përshëndetën mësuesin, i cili, si mbeti vetëm me mua, më tha të shkonim në një tavernë të mirë, të hanim, të pinim e të kuvendonim dhe në darkë do të isha mysafiri i tij, të rrija sa të doja e po të doja mund të lexoja ndonjë shkrim të tij. E falënderova për

mikpritjen e i thashë se nuk mund të rrija më shumë se një natë. Pashë se iu prish qejfi, donte të rrija më gjatë.

Ktheu kryet mënjanë, i fëshkëlleu dikujt si çunat dhe ja ku u duk një burrë i vjetër, nga veshja skllav, që iu përkul të zotit me nderim. Ishte koçari. Dolëm në rrugë, hipëm në koçi dhe nisëm të troshi-teshim nëpër kalldrëmin e rrugës rrëzë Akropolit. Shtëpitë tani vinin më të dendura, u dukën edhe dyqanet e pijetoret e lagjes, ndonëse jo lagje qendrore. Në një lokal pranë Teatrit të Dionisit, rrëzë Akropolit, më ra në sy një tabelë me shkronja me ngjyra të ndritshme ku shkruhej **KURVËTORE** dhe në të majtë të hyrjes ishte reklamë e madhe sa një bojë njeriu që paraqiste një bukuroshe gjysmëlakuriq.

Zenoni e vuri re shikimim tim, buzëqeshi e më tha, Këtu janë kurvat më të bukura të Athinës. Pronarja kërkon shumë, po të qeras unë, mund të shkosh që tani, ka brune e bjonde, të kolme e imcake, si t'i duash. Ia ktheva me buzë në gaz se hëpërhë nuk kisha nevojë (në fakt ma kishte qejfi, po më vinte zor), dhe koçari vazhdoi rrugën. Te taverna e Dhimos!, i tha Zenoni koçarit dhe pas disa minutash koçia u ndal përpara një taverne afër qendrës së qytetit.

Taverna ishte plot me klientë. Shumica e përshëndetën Zenonin me respekt, kurse mua më panë me kureshtje. U ulëm dhe në çast ia mbërriti kamerierja, një zezake bukuroshe, me një një trup të derdhur e gjinj të mëdhenj, më hodhi një vështrim të ëmbël e duke m'u mbështetur lehtë në sup na pyeti ç' do të merrnim. Zenoni shpalli:

-Dy koka dashi të pjekur, dy gjuhë, dy bërçolla derri, dy thëllënza, dy kupa xanxiqe dhe dy poçe verë, po deshëm prapë, të them vetë.

U habita me atë menu aq të pasur, kur mua do të më mjaftonte vetëm një gjysmë koke dashi, po nuk thashë gjë. Erdhi porosia, ngritëm shëndetet për njëri-tjetrin e duke ngrënë e pirë u shtruam në muhabet. E pyeta për thelbin e filozofisë së tij, por më ndërpreu:

-E ç'filozof jam unë? Jam Anaksagora, Pitagora, Sokrati, Platoni apo Aristoteli? Unë përpiqem të them diçka dhe aq.

-Po ajo diçka është madhështore, - i thashë dhe e ndjeva se po më kapte vera. Gjellërat ishin aq të shijshme, sa nuk tregohet. - Jeni i pari që keni hedhur idenë e madhe të lirisë si shkrirje me natyrën, si shembulli i përkryerjes së saj, - vazhdova me pasion. - A nuk është kjo thelbi i filozofisë suaj?

Më tha se boshti i saj ishte afër asaj të bashkëkohësit të tij të madh Epikuri (Zenoni ishte tetë vjeç më i vogël), ndonëse u përkisnin dy

shkollave të ndryshme. Edhe Zenoni theksonte rendjen pas lumturisë, kërkimit, pasionit, mençurisë, marrëzisë, urtësisë...

-Cila është liria më e madhe? - e pyeta.

-Liria e ideve. Është zgjerim i harmonisë kozmike.

Mirë, po a e merrni me mend përse më dënoi diktatura?, desha t'i thosha. *Për lirinë e ideve*. Si të ma kishte lexuar mendimin, Zenoni më tha se demokracia athinase ishte deformim i republikanizmit, çka ishte vërtetuar më parë me Sokratin.

-Teorinë tuaj do ta thellojnë edhe filozofë të tjerë, - i thashë. - Për shembull Kleanthi....

Zenoni më pa me habi.

-E paske dëgjuar? Jemi moshatarë dhe miq. Diskutojmë e zihemi shpesh, po është njeri i shkëlqyer dhe shumë i thellë. Atij po, i them filozof unë. Është dy vjet më i vogël se unë, po shumë më i ditur.

Heshti pak e shtoi:

-Ka një grua të bukur, një vogëlushe të ëmbël, dhe e ngacmoj: do të ta rrëmbej Aspën. Po nuk ma merr për keq, e di që nuk e bëj, nuk shkoj kurrë me gratë e miqve. Po ju andej si e keni këtë, të lejueshme?

-Si rregull, jo, - i thashë, po nuk u ndala shumë në atë pikë, se do të më duhej t'i thosha se për këto punë andej nga ne kërciste pushka, ndonëse unë, edhe pushkë të kisha, nuk do ta kisha vrarë kurrë Saimirin, po Zenoni nuk e dinte ç'ishte pushka, do të më pyeste për të, mund të më merrte edhe për të lajthitur e mund të prishej fare gjithë ai muhabet i këndshëm e i përzemërt.

-Mua më intereson të di pse e theksoni aq fort etikën në filozofinë tuaj, madje e bëni baras me logjikën, e cila duhet të jetë baza e bazave. Ju me të drejtë theksoni materialitetin e botës dhe pranoni *logosin*, arsyen hyjnore, pjesë e së cilës thoni se është shpirti i njeriut.

Zenoni qeshi, rrëkëlleu poçen e verës, porositi dy të tjera, ama të pirë që bënte!, më hodhi dorën në sup e më tha me mirëdashje:

-Sepse, i dashur koleg, pa një etikë të mirë nuk mund të lindë kurrë një filozofi e mirë. Etika është më e gjerë se filozofia, parimet morale themelore gjenden në të gjitha filozofitë, kurse teoritë filozofike janë pa fund dhe nuk i hedhin poshtë parimet themelore të moralit, që numërohen me gishta. Asnjë moral nuk e përllig kusarinë, poshtërimin, përdhunimin e të tjera e të tjera, por disa filozofi pranojnë disa parime që janë moralisht të papranueshme për një tjetër, për shembull, homoseksualizmin. Edhe disa nga filozofët tanë e pranojnë dhe përgjithësisht morali ynë e pranon, ndonëse teoria ime

është kundër tij. Po ashtu, në disa vende, morali e quan të papranueshme skllavërinë. Budizmi, me sa di unë, nuk e pranon. E njihni budizmin?

-Pak. Di se Buda ishte njeri, më pas u shfaq si perëndi. Rëndësi ka që njeriu te Buda gjen njeriun, çka nuk e gjen te një perëndi që është i parrokshëm për të. Në vramendjen e tij njeriu më mirë kupton sivëllanë e vet, sesa një perëndi. Gjen tek ai limitet e veta dhe pret me ankth zgjidhjet që do t'i japë ky njeri-perëndi, që atë e mendojnë si njeri.

Zenoni më pa me admirim.

-Pra, qenkeni filozof.

-Jo. I studioj filozofët, bëj ndonjë sprovë edhe vetë, po jam larg filozofit.

-Jo, jo, je filozof, - tha Zenoni dhe rrëkëlëu poçen e tretë të verës. - Po a s'u japim fund llogjeve për filozofët, se na u pordhën trutë? Bëjmë një shëtitje dhe në darkë shohim *Elektrën*, nuk më mërzit kurrë ajo dramë.

Zenoni pagoi, i la një bashkish të mirë kamerieres, dolëm e hipëm në koçi. Shkuam në qendër të Athinës, ku pashë *Areopagun*¹, *Pniksin*, vendin e mbledhjeve, shkuam te *Porta e Shenjtë*, kaluam *Qimiteron* e dolëm në *Rrugën e Shenjtë*, në vendin ku ajo kryqëzohej me rrugën *Ermou*, shëtitëm si dy djem shkollë duke bërë shaka e qyfyre, ishim çakërcej nga vera dhe kur zbritëm nga koçia ende na merreshin këmbët. Kudo shiheshin afishet e *Elektrës* së Euripidit.

Nga një kurvëtoreshë në anë të sheshit *Sindagma* doli një bjonde e bukur, iu afrua Zenonit, e kapi nga supet, e puthi dhe, siç duket, donte ta merrte brenda, po Zenoni nuk pranoi, i tha se ishte me një mik, domethënë me mua. Vajza më hodhi një vështrim e tha, Kemi vajza dhe për miqtë, ose, pasi të mbarojmë bashkë, ia bëj qejfin edhe unë po qe se ia mban xhepi. Nuk është aty puna, ia ktheu Zenoni, xhepi i tij është xhepi im, po kemi punë të tjera. Ai i dha kurvës një të puthur, i fali një metelik dhe vajza hyri në lokal gjithë qejf.

Teatri i Dionisit në jug të Akropolit, pranë *Odeonit* të Perikliut, llamburiste nga fenerët e vendosur në disa shtylla të larta në të dyja anët e skenës. Shkallët e panumërta ishin plot me spektatorë. Ne kishim zënë vend në rreshtin e parë, ku uleshin njerëzit e zgjedhur të qytetit dhe shërbyesi i teatrit na shtroi shiltet e buta për të ndenjur

1 këshilli i arkondëve i krijuar nga Soloni; Gjykata e Lartë në Athinën e Lashtë

rehat në shkallët e gurta. U dëgjua një melodi e ëmbël flauti, pastaj ca tinguj harpe, doli kori që u nda në dy pjesë dhe shfaqja filloi.

Tragedia *Elektra* edhe mua më pëlqente, Elektra është nga personazhet femra më të dashura për mua, në mos më e dashura, po shfaqja më zhgënjeu. Elektrën e luante një djalë i veshur si femër, zërin e kishte të hollë dhe maska e tij e ngrirë, ndonëse e pikturuar bukur, ta shpifte, po nuk i thashë gjë Zenonit se nuk doja t'ia prishja magjepsjen. Ku ta dinte ai i gjori se ç'ishte teatri modern, ndoshta jo aq i thellë në mendim, por i pasur në butafori e me shumë skena të gjalla; ku ta dinte ai se në skenë femrat i luanin femrat dhe, kur rolet ishin të bukura dhe aktoret të talentuara, të magjepsnin. Ku ta dinte ai se në filma aktoret i shihje edhe lakuriq e madje duke bërë seks. T'ia thosha këto do të më merrte për të shfazuar e do të më vinte drunë.

Dolëm nga shfaqja, i hipëm koçisë dhe mbërritëm përpara portës së Zenonit. Ai dërgoi koçiarin të thërriste Kleanthin, Thuaji të vijë patjetër me gjithë Aspën, e porositi, dhe hymë. Ishte një shtëpi e bukur dykatëshe, me pjesën ballore e me dy pjesë anash, një ndërtesë në formë U-je, pjesën bosh të së cilës e zinte një oborr i vogël. Nëpër ballkonet me pilastra vareshin fenerë të ndezur që e bënë dritë hapësirën laragane dhe tejprtej oborrit ngrihej një pjergull që kishte filluar ta humbiste gjelbërimin, po jo bukurinë. Në qoshen e majtë ndodhej një pus me bordurë guri e me skelë.

Oborri rreth shtëpisë ishte plot pemë, lule e pjergulla dhe nga fenerët e ndezur nëpër kopsht që plagosnin terrinën mund ta shijojë për mrekulli magjinë që të ngjallte. Në mes të kopshtit ishte një qoshk a belvedere, po jashtë bënte fresk e hymë brenda.

Salloni ishte i gjerë, i mobiluar bukur. Një skllav nxitoi të ndihmonte të zotin të zhvishej dhe të vishte rrobat e shtëpisë, një tjetër i sollti një palë pantofle të buta, po Zenoni i urdhëroi të kujdeseshin më parë për mikun. Ata nisën të merreshin me mua, sipas zakonit më pyetën mos kisha nevojë për të shkuar në banjë, gjë që ishte e vërtetë se mezi po e mbaja shurrën që kishte nisur ta ndieja që kur mbaroi shfaqja.

Skllavi më udhëhoqi gjer te banja, në një qoshe të shtëpisë. Banja ishte e gjerë, me një vaskë terrakote. Skllavi më pyeti nëse dëshiroja të bëja një banjë që të lëshonte në vaskë ujin e ngrohtë. I thashë hëpërhë jo, pak më vonë mundet, se nuk duroja dot sa të shurroja.

Skllavi priste jashtë derës që të bënte shpëlarjen e nevojshme. Më erdhi zor që rrinte atje, se nuk e mbajta dot një pordhë, po fundja skllav është, thashë me vete, edhe pordhët e zotërinjve do t'i dëgjojë, po shyqyr banja ndodhej larg sallonit dhe nuk besoj që pordha të ishte dëgjuar deri atje.

Një skllave zeshkane, e bukur perri, me emrin Teota, më udhëhoqi në *andron*, në dhomën e burrave. Quhej ashtu për zakon, se Zenoni nuk e respektonte fare, në të futeshin edhe gratë, që flinin në *gjinecium*. Pas pak erdhi Kleanthi me të shoqen, një bjonde e lezetshme, pak e shkurtër, po me trup të bukur, e freskët si kumbull, që m'i nguli sytë me kureshtje. Kleanthi ishte nën të dyzetat, po ngjante si djalosh, kishte një fytyrë të pastër, të rruar taze, me një palë sy të zgjuar dhe buzëqeshje të ëmbël. Më mori ngrykë si të më njihte prej kohe.

U ulëm në andron e ia nisëm muhabetit dhe Kleanthi na pasqesh qëlluar një njeri me humor të rrallë, *i dyti në Athinë pas Sokratit*, tha Zenoni. U shtrua me të ngrëna e të pira, me shaka e biseda, dhe darkë si ajo s'kisha parë kurrë. Pas pak erdhën muzikantët dhe tri balerina, i kishte thirrur Zenoni nga një kurvëtoare aty pranë po që ishin edhe valltare. Filloi vallëzimi, u ngritën edhe Kleanthi me të shoqen, edhe Zenoni me Teotën, donin të më merrnin edhe mua, po unë jam tapë për të kërcyer, megjithatë bëra si bëra e nisa të kërcëja.

Një nga balerinat, e hollë si kallam, me kokoridhka të verdha e të dendura, me një fytyrë e trup që të linte pa mend, e veshur me një fustan mëndafshi të murrçimë, m'u qep keq, nuk më lëshonte dhe, fshehurazi, më puthte. Kujtova se ishte nimfomane¹, po jo. Eja sonte me mua, më tha, të marr pa para, kam qejf të bëj dashuri pa honorar dhe nuk kam të dashur. M'u lut të bëshesha i dashuri i saj, pranonte të linte edhe punën për mua, ose të punonte si kameriere apo pjatolarëse, mjafton që të bëhej gruaja ime nëse pranoja për grua një prostitutë. Nuk fola, edhe mua më pëlqente dhe nuk çaja kokën që ishte prostitutë, po të nesërmen që në mëngjes do të largohesha.

Pashë se iu mbushën sytë me lot dhe vazhdoi kërcimin duke u varur e tëra mbi mua. Më tha se ishte nga Qiproja, çka më habiti, se qipriotet i dija të gjitha brune, se e quanin Minerva, ishte rritur në Athinë dhe më tregoi ca hollësi të tjera që s'i mbaj mend. Vallëzimi pushoi e u mbushëm me frymë, nisëm sërish të hanim e të pinim dhe

1 femër që karakterizohet nga një dëshirë seksuale e sëmurë, e pakontrolluar

të tregonim shakara. Objekti i bisedës u kthye te filozofia, ose më saktë te filozofët, te antikllëqet, qyfyret apo anekdotat për ta dhe Kleanthi nisi të fliste për Diogjenin, filozofin më të çuditshëm për nga zakonet që kishte njohur Athina gjer atëherë, tha, dhe tregoi një ndodhi në lidhje me të e Platonin, që më pëlqeu shumë.

-Platoni, filozof i madh, por sqimatar e aristokrat, që dinte të gjente të mesmen e artë dhe nuk i kundërvihej pushtetit, siç bëri Sokrati, mësuesi i tij, i kishte zët cinikët, sidomos Diogjenin. Një herë u grindën keq dhe Platoni e shau *qen*, prej nga vinte dhe emri i tyre, se predikonin jetën me moral të lirë, madje Diogjeni nuk kishte as shtëpi, po jetonte në një vozë. Në fakt e kishte një barakë, po njerëzit i zmadhojnë gjërat. Nejse, një ditë qëllon që Platoni kalon me koçinë e tij lukzose pranë barakës së Diogjenit dhe i flet me tangarllëk, pa zbritur për ta takuar. Hë, mor *qen*, i thotë, si ia kalon? Mirë, iu përgjigj Diogjeni, po eja të këmbejmë dy fjalë, se qen jam vërtet, po mos ki frikë nga unë, nuk jam nga ata që hanë mut.

Qeshëm të gjithë. Kleanthi vazhdoi me qyfyre, darka mbaroi dhe mysafirët u ngritën, por Zenoni kishte plot dhoma dhe i mbajti për të fjetur, se kishte kaluar mesnata. Mua më tha mënjanë se po të doja mund të flija me Teotën, skllaven e tij. E falënderova e i thashë se po të më lejonte, doja të rrija me një nga balerinat, më ishte lutur vetë. Pranoi me kënaqësi, po të duash merri të tria, më tha, krevati mban vetëm dy veta, po në dhomë janë edhe dy minderë e mund të rregullohen atje. Jo, ia ktheva, do të marr vetëm Minervën.

Hymë në njërën nga dhomat e mysafirëve, në katin e dytë, një dhomë e madhe, e mobiluar bukur, me orendi të Lindjes. Kishte njëfarë joshjeje e misteri ajo dhomë që nuk e kisha ndeshur kurrë, binte erë mirre e trëndeline, në mure kishte piktura të bukura, nëpër vende të ndryshme vazo të kushtueshme dhe stauteta. Krevati ishte i gjerë sa për tre veta, por Minerva, sapo hymë, as që ia hodhi sytë dhomës, mbylli derën pas vetes e m'u hodh në qafë duke më puthur fort gjithë drithërima e ofshama, ma zuri frymën fare, aq shumë e zgjati puthjen.

E mora peshë dhe e çova në krevat, ajo filloi të zhvishej e të më zhvishte edhe mua. Hapëm mbulesat dhe nisëm ledhatimet, unë me ashkun e një adoleshenti, ajo me zjarrin e saj të natyrshëm, se ndonëse jo adoleshente, nuk ishte më shumë se 25 vjeçe. U zhvesh e u hodh mbi trupin tim ku prapë më mbuloi me të puthura, puthte

gjoksin tim leshtor, buzët, sytë, mjekrën gjysmë të thinjur. I ngjan Leonidhës më tha, burrit më të pashëm që kam parë, jo, më i pashëm ka qenë Epikuri, portretin e të cilit e mbaj në shtëpi, se as Leonidha nuk ka hijeshinë e tij, ka një bukuri prej femre Leonidha.

U habita se sa mirë i njihite burrat e shquar të Greqisë, sidomos meshkujt e pashëm. Nuk ke ndot që bën dashuri me një putanë?, më pyeti pas pak me zë të mekur teksa i ledhatoja kurmin e saj të brydhët. Pse të kem ndot?, ia ktheva me zë të butë e m'u dhimbs, ishte aq e dashur dhe e çiltër. Të gjithë jemi nga pak putanër, i thashë, edhe njeriu më i pastër e ka një putanllëk brenda tij, këtë nuk e them unë, e ka thënë Krishti para meje, për të cilin ajo me siguri dinte më shumë se unë, se vendlindja e saj ndodhej afër Judesë, por në çast u kujtova se Krishti s'kishte lindur në atë kohë, dhe e vazhdova dashurinë me të gjer në trallisje, tamam si djalosh, dhe për një çast m'u kujtua *Ajo* dhe u mpiva i tëri.

Minerva ngriu dhe më pa e hutuar. Ç'ke, më pyeti, nuk je mirë? Kam pirë pak si tepër, ia ktheva, por ngaqë më vinte keq për të, por edhe ngaqë kishte një fytyrë e trup të brishtë e të njomë, seksualisht tmerrësisht joshës, gati aq të bukur sa të *Saj*, ia fillova prapë dhe u lumturua.

Vetëm afër mëngjesit mbyllëm sytë, në fakt unë se, siç më tha ajo, ajo nuk kishte fjetur, rrinte e më kundronte teksa flija dhe nuk reshtte së më ledhatuari lehtë, aq lehtë, sa të mos më zgjonte.

Kur i thashë se do të nisesha për larg, ndoshta për të mos u kthyer më kurrë, ia plasi të qarit, m'u lut ta merrja me vete kudo që të ishte, edhe në fund të botës, edhe në atë vendin tim të *barbarëve*, jo, ti s'je barbar, më tha, je filozof, i mençur, i hijshëm, barbarët s'janë të tillë, kaq të qytetëruar e të kulturuar, kaq të ëmbël e delikatë në sjellje, dhe unë me vete pohoja, Po, nuk jemi *barbarë*, jemi shumë të qytetëruar, po nuk ishte nevoja t'ia thoshja këtë derisa po ma thoshte vetë.

U veshja e u bëra gati të dilja dhe ajo nuk reshtte së qari, i dridhej trupi, supet e zhveshur, flokët e verdhë. O Zot, vetëm *Ajo* kishte qarë ashtu, po kur? Në ç'kohë? Nuk e mbaja mend, ndoshta para mijëra vjetësh dhe shpirti i saj kishte kaluar te Minerva, në një trup tjetër, a nuk thoshin Vedat se ekziston rimishërimi?, por nuk ia përmenda Minervës emrin e *Saj*, e putha për herë të fundit e dola, kurse ajo u plas në krevat e iu zu fryma nga të qarët.

Desh u ktheva për ta qetësuar, po e mblodha veten dhe dola i vendosur, me shpirtin plagë. Po të kthehesha do të vuante më shumë kur t'i humbte sërish çastet e fundit me mua. Vetëm kur hyra në andron dhe ndesha fytyrën babaxhane të Zenonit u qetësova. Ai më ftoi të pinim nga një çaj sa të na sillnin mëngjesin, por i thashë se nuk doja mëngjes, do të pija vetëm çajin e do të nisesha.

Eja prapë, më tha, rrallë më kanë qëlluar mysafirë kaq të këndshëm, tani u binda se ne kemi përfytyrim të gabuar për *barbarët*, po paska pasur të drejtë plaku Sokrat kur thoshte se barbarët janë më të qytetëruar se ne, nuk fliste kot ai plak i mençur. Erdhi koçia e hipëm të dy, më përcolli deri në Pire. Ktheu, i thashë, se ke mësim. Jo më tha, mësimin e bën Kleanthi, u kënaq shumë me ty dhe të bën shumë të fala.

U puthëm buzë më buzë, u ndamë dhe pashë që u përlot, po e mbajti veten dhe bëri një shaka, Po qe se ajo balerina sëmuret nga malli për ty, më tha, po ta nis me postë, vetëm më lër adresën. E ç'adresë t'i lija, atë të spitalit?

Ajo ka qenë një nga vizitat e mia më të bukura gjatë gjithë jetës. I hipa anijes më të parë që shkonte për në Dyrrah duke i lënë lamtumirën mikut tim Zenon, Atikës e Heladhës...

2

U gjenda sërish në dhomën time të spitalit, me drekën të pa-prekur mbi komodinë. Hyri sanitarja, siç duket për të marrë tabakanë me pjatat bosh, por kur pa që unë ende s'kisha filluar të haja, u habit.

-Z. Viktor, - më tha, - erdhi një burrë te ju, po nuk e njohët. Tha se quanin...

Nuk po i kujtohej emri i vizitorit.

-Duhet ta ketë shënuar aty, - bëri me shenjë për nga nënkresa ime, - se ju la një letër. Ju solli dhe disa ushqime.

Ktheva kokën me rrëmbim nga nënkresa. Sanitarja doli. Mora letrën dhe e përpiva me sy. Qe shkruar me nxitim me stilolaps, kishte dy njolla në të, ndoshta dy pika lotësh.

I dashur Viktor,

Jam Denisi që ju shkruaj. Erdha t'ju takoja, po nuk më njohët, prita një orë në dhomën tuaj. Besoj se do të kujtoheni kush jam. Që kur dola nga burgu kam pyetur për ju, po nuk kam patur mundësi t'ju vija më shpejt. Doja të këmbenim dyfjalë e t'ju kërkoja ndjesë për sjelljen time atë natë, kur ju qëllova me grushte në rrugicën tuaj, e mbani mend? Gjithsesi, mos më kujtoni për keq. Në fillim ju kam urryer, po pastaj ju kam dashur si vëlla.

Po nisem për larg, dhe nuk i dihet se kur mund të shihemi përsëri. Do të kërkoj mamanë dhe nipin, thonë se janë në Amerikë. Po qe se i gjej, do të bëj çmos t'ju njoftoj.

Ju uroj shërim të shpejtë. E marr me mend sa këni vuajtur në burg, ndofta më shumë se unë. Ju përqafoj si vëlla,

Denisi.

Mbeta për një kohë të gjatë me sytë të gozhduar te letra, pastaj i hodha në mur, mbi portretin e Zenonit, sikur të doja t'i thosha, Eh, mor i dashur! Vajta e shkova në vendin tënd kur s'duhej. Sytë m'u mbushën me lot. Sa keq që nuk qeshë takuar me Denisin!

Ditët në spital rridhnin të njëtrajtshme, pak a shumë si ato të burgut, se edhe spitali si burg ishte: daljet në oborr i kisha të kontrolluara dhe nuk më lejohej të shkoja as te klubi aty pranë për të pirë një kafe ekspres, se kafe turke bëja në dhomë, Flora më kishte sjellë një furnelë me alkool dhe takëmet e tjera. Kur më shkrepej të pija kafe ekspres, përherë më shoqëronte një infermier a inferimiere dhe një herë më shoqëroi vetë Dr. Hysa.

Si rastësisht ai e hapi sërish atë punën e krimit që i kisha thënë se kisha bërë dikur, po unë prapë gur varri. Isha betuar se nuk do t'ia tregoja. Mbase ishte dhe në dëmin tim, se kisha lexuar ca libra mjekësorë, sidomos të Frojdit, që thoshin se nxjerrja nga thellësitë e nënvetëdijes e një të fshehte që gjallon atje pavetëdijshëm krijon një lloj çlirimi nga stresi i vetëdijshëm, stres që i sëmuri e ndien, çka çon në çlirim e kthjellim të vetëdijes, domethënë në shërim dhe normalizim të veprimtarive psikike të njeriut. I dija këto, po Dr.

Hysës nuk i tregova asgjë për krimin, as atë ditë kur pimë kafe. Isha shumë i kthjellët, madje bëra dhe humor, i thashë se në një pavijon tjetër isha njohur me një regjisor filmi vizatimor që më kishte thënë se në marsin e vitit të kaluar, në ditët e përmbysjes së madhe, kur kishin fituar demokratët dhe opozita e rrëzuar kishte nxjerrë tanket në rrugë, atë e kishte shtypur një tank, e kishte bërë petë, po falë fatit të tij që kishte bërë filma të animuar, qe ngritur sërish si te *Tomi dhe Xherri* dhe lëvizte normalisht, vetëm se tani nga një qenie tredimensionale qe bërë dydimensionale, si në një film të animuar bullgar, më tha, që paraqiste një njeri të bërë me gazetë, një njeri-gazetë lëvizës që madje digjet në nja dy vende me cigare. Dhe u tremb kur unë ndeza një cigare, kishte frikë se mos i bëja padashur ndonjë vrimë në trup.

Më pas, për disa ditë nuk isha mirë, kishte ardhur Flora dhe nuk e kisha njohur dhe kur erdhi sërish pas një jave shumë e shqetësuar më tha se kisha patur halucinacione, flisja me ajrin, me boshllëkun, shaja policët, gardianët, përmendja emrat atë Pal, Pirro e Bedri, bisedoja me njerëz imagjinarë, shumica filozofë të lashtë, se përmendja emra si Zenon, Sokrat, Platon e të tjerë. Kjo gjendje nuk më zgjati shumë dhe fillova të lexoja, për të dhjetën herë, një vepër të Niçes, *Kështu Foli Zarathustra*, që edhe pse vende-vende shumë e errët, më pëlqente thujtase sa një kryevepër tjetër e tij, *Përtej së Mirës dhe së Keqes*.

Një ditë u zhduka përsëri dhe e gjeta veten në Gjermani, me një valixhe të vogël ku kisha vënë ca libra filozofikë. Se si kisha shkuar atje nuk më kujtohej, po gjithçka që ndodhi në atë vizitë e mbaja mend shkëlqyeshëm.

U gjenda në Naumburg, në qytetin e Niçes. Kisha marrë vesh se qe kthyer në shtëpi nga klinika *Binswanger* në Jenë dhe jetonte me t'ëmën. Për fat të keq komshinjtë më thanë se kishte ikur, e ëma i kishte vdekur dhe motra e tij Elizabetë kishte zënë një shtëpi me qira në Vajmar. Kështu që m'u desh të udhëtoja me karrocë për në Vajmar, që ndodhej rreth 70 km nga Naumburgu.

Gjatë rrugës për në Vajmar, që zgjati gjashtë a shtatë orë, u mrekullova nga peizazhi që shihja përreth - kodra të gjelbra me pisha e ahe, vreshta, ara të mbjella, lumenj të vegjël me ura të gurta. Mendoja dhe për krizën që kishte pësuar Niçja aq papritur disa vjet më parë në Itali, në Torino, kur kishte parë një karrocier që godiste

vrazhdë kalin e tij. Niçja i qe sulur kalit, e kishte përqafuar duke qarë si fëmijë dhe kishte humbur ndjenjat. Që atëherë mendja herë i ikte herë i vinte, duke e kredhur dhimbshëm në një terrnajë çmendurie.

Në Vajmar pata fat se karrocieri i parë që pyeta, taksixhi dhe ai, më dha të dhëna të sakta për banesën e re të Profesorit të Madh. Se i shkojnë shumë vizitorë, më tha. Hipa në karrocën e tij e me vete uroja të mos gjeja në shtëpi ndonjë vizitor që të bisedoja më nge me Niçen. Pas gjysmë ore karroca ndali në periferi të qytetit, rrëzë një kodre të bukur, të mbytur nga gjelbërimi, me pisha, bredha e kopshte me trëndafila. Në mes të një kopshti të tillë ngrihej vila *Silberblick*, që të mrekullonte me pamjen dhe hijeshinë e saj, me një pjesë të mureve me bimë kacavjerrëse. Pagova karrocierin, mora valixhen e u ndala përpara portës së madhe që u hap vetiu, duket portieri më kishte parë kur zbrita nga karroca. Nuk më pyeti ku shkoja, u përkul me nderim e më bëri shenjë se mund të vazhdoja.

Eca përgjatë një rrugine të shtruar me një kalldrëm me gurë ngjyra-ngjyra dhe trokita. Derën ma hapi një mesogrua e hijshme, me sy të ëmbël në ngjyrë lajthie, që më vështroi buzagaz dhe me shumë respekt më ftoi të hyja. E mora me mend se duhej të ishte Elizabeta, motra e filozofit, që ishte kujdesur aq shumë për të vëllanë e sëmurë. Me sa duket më mori për ndonjë nga profesorët e Lajpcigut, që kohët e fundit e vizitonin Niçen shpesh.

Më futi në paradhomë e që aty në një sallon të gjerë, të ndriçuar me llamba elektrike të modelit të vjetër. Mobiljet ishin të stilit barok. Një bibliotekë e mbushur cit me libra, e punuar prej dru mogani të gdhendur me ksilografi të përsosur, ngrihej deri në tavan; në dritare kishte perde të rënda, të hapura përgjysmë; mbi një tryezë në cep të sallonit ishte një gramafon me hinkë, diku më tej një piano, divanë e kolltukë anglezë prej lëkure të stilit viktorian.

Sa hyra në sallonin e pritjes më doli përpara vetë Niçja. Më bëri përshtypje fytyra e tij - sy inteligjentë, pak të mugullt, flokë gështenjë thujse të pathinjur e një palë mustaqe si xhufka që i vareshin mbi buzë. Më priti gjithë përzemërsi, krahëhapur, ndonëse në fytyrë i endej pikëllimi, shihej qartë që vuante nga sytë, madje ishte duke u verbuar. Më pyeti kush isha.

-Demiurgu Filozof, - i thashë me shaka. - Ose Filozofi i Çmendur.

-Ju mirëpres për të dy titujt, - ma ktheu po me shaka. - Për më tepër që asnjë filozof që njoh nuk ka pranuar se ka qenë i çmendur,

veç meje.

-Aq më mirë, - ia ktheva me gaz. - Dy të çmendur kuptohen më mirë.

-Si zor, - më tha. - Dy të çmendur nuk bëjnë një të Mençur. Nejse, mirë se erdhët dhe urdhëroni.

Më kapi nga dora e më uli në divanin e madh, më ofroi një puro e më zgjati një kuti me çokollata. Më pyeti kush isha e nga vija. Ia thashë, nisi të mendohej se ku binte vendi im. Në mur varej një hartë e madhe, shkuam pranë saj dhe ia tregova. Aha, më tha, në mos gabohem Bismarku, udhëheqësi ynë i nderuar, e ka quajtur shprehje gjeografike. Më hipën nervat, po për mirësjellje e mbajta veten, thjesht i thashë që prijësit të një kombi të madh nuk i lejohet të mos dijë se cilat vende në botë janë *shprehje gjeografike* e cilat janë shtete të mirëfillta e të lashta. Vuri buzën në gaz. Ishte moshatar me Bismarkun, madje e njihte nga afër.

U ulëm sërish dhe nisi të më pyeste për vendin tim. I fola për të dhe më dëgjoi me vëmendje. I fola edhe për shqipen, se Niçja kishte interes për gjuhët, ishte poet e filolog. I thashë se është gjuhë indoevropiane, jashtëzakonisht e pasur në fjalë e idioma, shumë poetike e figurative. Mirëpo është për të ardhur keq, shtova, që shumë libra e gazeta, madje edhe institucione, e dhunojnë duke mos respektuar drejtshkrimin.

-Pse, ka edhe institucione që nuk e respektojnë? - më pyeti me habi.

-Po. Ministria jonë e Kulturës, për shembull, jep çdo vit një çmim nderi për librin më të mirë të vitit që quhet *Penda e Argjendtë*. Për çudi, në pllakëzën e trofeut fjala *e Argjendtë* është shkruar gabim.

-Mos more! - u habit Niçja. - Po a është insitucion kulture?

-Sipas emrit, po. Pale në Ministrinë e Arsimit. Një profesor yni i nderuar ka kritikuar në shtyp një qarkore greth me gabime drejtshkrimore të firmosur nga vetë ministri, njëfarë Leon Memisha.

-Ou! - ia bëri Niçja. - Ai ministër ose duhet të futet në kurs drejtshkrimi, ose duhet pushuar nga puna.

Dhe i kureshtuar më pyeti nëse kishim fjalor normativ të gjuhës shqipe. Kemi, i thashë. Për fat kisha marrë me vete Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, që e nxora nga valixhja dhe ia tregova. E mori në duar dhe e pa me interes, duket i pëlqeu. Është për ibret, i thashë. U kujtova se atë shprehje e kisha përdorur në mënyrë pira-

teske, se në Fjalor (të cilin e shkruaj më F të madhe, si hambar i gjuhës që është) nuk ekzistonte. Niçja më hetoi si për t'u bindur në kishte të bënte me një njeri normal a me një psikopat, siç i kisha thënë në fillim. E ndjeva mosbesimin e tij dhe m'u desh të përligjesha.

-E cilësova ashtu se nuk përmban shumë fjalë që përdoren sot, z. Niçe, ndonëse në emërtim thotë se është fjalor i gjuhës së sotme.

Niçja më pa me mosbesim dhe u ndjeva në siklet. S'ka më turp sesa të kritikosh pa vërtetuar gjë. Del sikur je përgojues, shpifaraq.

-Mund të ma argumentoni?

-Posi jo. Në spitalin ku jam unë është dhe një kinez që vuan nga pagjumësia. Flet dhe lexon shqip. Një mbrëmje më erdhi në dhomë e m'u lut ta ndihmoja me një fjali, se Fjalori, s'po i bënte punë. E shoh fjalinë, bajagi e vështirë. E mbaj mend, se më është fiksuar: "Kryeprihti u zhyt në *oramendje* dhe duket u *ndërgjegjësua* se *magët e ligj*, në atë sfond me *rozeta*, *betele*, *mirrë*, *harpia*, *linçë*, *pardë*, *kimera*, *hidropë*, *llukratë*, *baziliskë*, *ypnalë* e *dipsodë* e kishin ndërprerë *alelujën* dhe sipas *këndvështrimit* dhe *qasjes* së tyre e kishin marrë *pandehmën* e tij për një *mendjeshkrepje gjasme halucinante* dhe e kishin *sikterisur*." Nuk mora vesh asgjë. Kërkova në Fjalor për fjalët e panjohura, nuk ishin. Mbeta pa mend. Nuk e kisha ditur se sa larg është Fjalori nga gjuha e lëvruar.

-Mos janë fjalë të huazuara? - më pyeti Niçja.

-Disa po. Si çdo gjuhë, edhe shqipja ka fjalë të huazuara. Lexuesi i ndesh në libra dhe do t'u dijë kuptimin, por nuk i gjen në Fjalor. Kjo më habit. Përderisa njerëzit e kulturës - shkrimtarët, përkthyesit, filologët, filozofët... i përdorin këto fjalë, Fjalori pse t'i përjashtojë?

Flisja me rrëmbim. Me sa duket pjesa e gjymtë e mendjes sime kishte marrë përparësi ndaj së shëndoshës.

-Por çka më habit më shumë, - vazhdova me duf, - është se Fjalori ynë dukjemadh nuk përmban edhe shumë fjalë të kulturës e të artit si *këndvështrim*, *qasje*, *i sofistikuar*, *neorealizëm*, *videoklip*...

-Çfarë, çfarë? - më ndërpreu Niçja dhe e kuptova lajthitjen. I kisha përmendur fjalë që në kohën e tij nuk ekzistonin. Bëri mirë që më ndërpreu, se do të kisha vazhduar edhe me fjalë të tjera që përdoren sot, por që Fjalori s'i ka, si *videotekë*, *telekamerë*, *logo*, *film* *i animuar*... ndaj vazhdova me fjalë të dijes, të politikës, të moralit apo të sferës erotike që Niçja i dinte, si *apokrif*, *okult*, *autosugjestion*, *refleksion*, *introspeksion*, *synops*, *fakultativ*, *licensë*, *certifikoj*, *sinergji*, *amok*, *fundamentalizëm*,

totalitarizëm, kurorëshkelje, erotizëm, orgazëm, lezbizëm, biseksual, pederast, homo, homoseksualizëm, kurtizanë, kurvë...

-Një minutë, - më ndërpreu Niçja. - Ka kurva te ju?

-Edhe ka, z. Niçe. Si kudo.

-Epo një vend në Fjalor u takon. S' u duhet ngrënë haku.

-Dakord, po s' është puna vetëm aty. Puna është se shumë fjalë erotike, të cilat tashmë kanë hyrë edhe në gjuhën ligjore për arsye se lidhen me probleme që rrihen nga shoqëria, për Fjalorin janë të papranueshme.

-Çudi! Kaq të madhe e paska gjeten e fikut Fjalori juaj?

-Shumë të madhe, z. Niçe, - ia ktheva buzagaz.

-Mirë këto fjalë, po duke qenë se gjuha juaj është shumë e pasur, mbase Fjalori nuk ka vend për ca fjalë jo fort të rëndësishme?

-Nuk e kam fjalën për të parëndësishmet, z. Niçe. Puna është se leksikografia jonë vuan nga akademizmi dhe ekzibicionizmi. Pse, të parëndësishme janë fjalët *ndërgjegjësohem*, *pandehmë* apo *qasje*? Po sikur Fjalori juaj të mos i kishte?

-Do të ishte për të fshirë bythën, - tha Niçja.

Qesha. Duke parë se biseda për gjuhën dhe për Fjalorin u zgjat si shumë, e mbylla me marifet dhe u hodha në fushën e filozofisë. Ia nisa me *Zarathustrën* ku Niçja shtjellonte gjerësisht *vullnetin për pushtet* dhe *mbinjeriun*.

Atë kohë erdhi Elizabeta që solli një tryezë me rrota në të cilën kishte pjata me ëmbëlsira, gota e shishe. Ajo më buzëqeshi me mirënjohje ngaqë i kisha ngjallur interes të vëllait në bisedë. Me ç' duket vizitorët e tjerë e mërzitnin.

-Urdhëroni, mik i dashur! - më tha Niçja me përzemërsi dhe më mbushi gotën me shampanjë.

-Që njeriu të vetëpërsoset, - i thashë duke çokur gotën me gotën e tij, - është gjë e mirë. Është e natyrshme të kërkojë të bëhet më fort krijues, sesa të mbetet një krijesë e thjeshtë. Po a është e vërtetë se kur dështon në këtë përpjekje kërkon, për kompensim, pushtet të vrazhdë mbi të tjerët?

-Pikërisht, - tha Niçja.

-Tek *Antikrishti* ju thoni se në raste të veçanta, në vende e kultura të ndryshme, janë ndeshur *tipa më të lartë* që, në raport me të tjerët, janë njëfarë Mbinjeriu. Sipas jush Ai afirmon jetën, është krijues vlerash, *moraliteti*, zbut dhimbjen që shoqëron ekzistencën njerëzore dhe

pasqyron forcën dhe pavarësinë e njeriut për t'u çliruar nga të gjitha vlerat, veç atyre që Ai i quan *të vlershme*. A ka të drejtë një individ të imponojë vlerat që vetëm ai i quan *vlera*?

-Pse jo? Ai nuk detyron, por parashtron.

-Po si i bëhet kur ai përmbys vlerat më të qenësishme të njerëzimit?

-Jo të gjitha vlerat janë të përjetshme.

-E kam fjalën për të përjetshmet.

-Dëgjoni, - më tha, - vullnetin për pushtet unë e shoh në sensin pozitiv, jo thjesht pushtet mbi të tjerët, por pushtet mbi vetveten, që është i nevojshëm për krijueshmërinë.

-Më falni, z. Niçe, po ju merrni si model Sokratin e Krishtin. Por Mbinjeriu nuk është përherë Krisht apo Sokrat. Teoria juaj është thellim i teorisë së Platonit, që është shumë fisnike, por është keqinterpretuar dhe i ka sjellë botës shumë mjerime. Filozofia juaj dhe e Platonit janë masakruar dhe nga kjo masakër kanë lindur shumë përbindsha, ndër të cilët po përmend dy, Diktatorin e vendit tuaj dhe atë të vendit tim. Të dy krijuan shtete totalitare. Juaji pati fuqi ushtarake dhe vrau me miliona, ai i vendit tim shkatërroi shumë vlera tradicionale dhe në emër të *rikrijimit të vlerave* krijoi *njeriun e ri*, një mostër të përbindshme.

Pashë se sytë e hijesuar, po gjithësesi vizionarë e kimerikë të Niçes, i mbyti pikëllimi.

-Vërtet janë sjellë si përbindsha? - më pyeti.

-Po. Ju nuk arritët t'i shihnit bëmat e tyre.

-Si ka mundësi të më kenë keqkuptuar? Unë e kam pasur fjalën për vlera *ndërtuese* të Mbinjeriu, jo për krime, vrasje, antivlera...

-Nuk e keni ju fajin, - i thashë me keqardhje, se doja me gjithë shpirt të qetësohej. - Fajin e kanë ata që shtrembërojnë Platonin e Madh. *Mbinjeriu* juaj dhe i Platonit është udhëheqës kombi në emër të njerëzimit, jo të *çnjerëzimit*...

-Pikërisht, o i huaj i dashur. Pikërisht!

Lëshoi pirunin ku kishte ngulur një copë pandëspanjë që po bëhej gati ta hante, u mbështet në shpinoren e divanit, hodhi vështrimin në tavan dhe pashë se sytë e mjegulluar nga verbëria iu mbushën me lot. Lotët i kullonin faqeve, i rigonin mbi xhakët dhe nuk kujdesej t'i fshinte. Rrinte pa folur, i trishtuar në kulm, me një ndjenjë pendese të thellë.

-Pse vallë njerëzit kanë dëshirë të shtrembërojnë gjithçka të

bukur, të drejtë e të mirë? Si mund t'i shërbejë *Mbinjeriu* njerëzimit duke e vrarë e shkatërruar?! *Mbinjeri* do të thotë njeri model, më i miri e më i përsosuri se çdo ekzemplar i njerëzve të rëndomtë!

-Më falni, z. Niçe, ju trishtova shumë. Në fakt jo unë, po e vërteta. Historia që erdhi pas jush...

Nuk di se prej nga nisi të kumbonte, fillimisht mbyturazi, pastaj fare qartë e pastër, një këngë e *Skorpionsave*, e atij grupi muzikor të mrekullueshëm, dhe pikërisht kënga *When the Smoke is Going Down*, e cila më pëlqente shumë. Nuk di nëse e dëgjonte edhe Niça atë këngë.

-Nuk kam si ju kundërshtoj, - tha dhe si u mbush me frymë, vazhdoi: - Eh! Të mund të rilindja pas një totalitarizmi të tillë vrustar do të dija si t'u përgjigjesha maskarenjve që e pollën atë duke keqpërdorur teoritë e mia. Më kanë shfrytëzuar qëllimisht, o i dashur mik i huaj! Udhëheqësit nuk kanë dashur vetë të shohin thelbin e *Mbinjeriut* tim! Kjo është e tmerrshme!

M'u dhimbs dhe u përpoqa ta merrja me të mirë. Ngrita gotën me shampanjë dhe e çoka me të. Pashë se nga sytë prapë i rrodhën lot. Si mos t'i rridhnin lot nga krimet e përbindshme të njerëzve atij njeriu të ndjeshëm, që kishte qarë pse karrocieri kishte goditur një kalë dhe që atëherë nuk e mori më veten kurrë nga ajo vuajtje që çoi në çmenduri?

-Mallkuar qoftë ajo filozofi që mëkon të keqen dhe mallkuar qofshin ata që spekulojnë me filozofinë e mirë!

-E lëmë *Mbinjeriun*, - vazhdova, - po ju thoni se Krishterimi ka lindur nga dobësia, dështimi dhe mllefi, është armik i arsyes, i ndershmerisë, i pushtetit, i gëzimit dhe i lirisë dhe në veçanti i seksit. Kjo thënie më duket se mbart pak të vërteta, hiq atë për seksin.

Dukej i përhumbur, nuk po më ndiqte fare. Me siguri përbluante thagmat që kishin ndodhur si pasojë e shtrembërimit të teorive të tij. Tani po dëgjohej një këngë e *Joe Cocker*-it, që dhe ajo më pëlqente shumë. Vazhdova bisedën dhe e pyeta:

-Ç' nuk ju pëlqen te Bibla?

U shkund e më pa në sy.

-Ç' nuk më pëlqen? Sipas saj, vdekja e parë në botë vjen nga një krim: vëllai vret vëllanë. Njerëzimi rrjedh nga ky kriminel. Ideja se njerëzimi fillon me krim më tmerron, më pëshpërit se krimin e kemi në gjak. Zoti e pa ç'ndodhi dhe s'e bëri qejfin qeder. Një ditë kujtohet se bota qenka mbushur me mëkate dhe dërgon të birin ta

shpëtojë. Po ai Zot që e bekoji mëkatin. Jo, i dashur. Jo. Vetëm Mbinjeriu *i njerëzishëm* e shpëton botën nga mëkati, - i dha fund Niçja asaj tirade të zjarrtë.

-Zoti nuk e bekoji krimin, - i thashë me njëfarë droje.

-Po as nuk e dënoi, çka do të thotë bekim. E mallkoi, por edhe e mori në mbrojtje: kush do ta prekte, do të ndëshkohej ashpër.

Heshti një grimë dhe pashë se u zbut. Me një buzëqeshje të lehtë nën mustaqet xhufkore, më tha:

-Me ç'pashë, nuk m'u dukët i çmendur. Të paktën jo sa unë.

-Ju nuk m'u dukët fare, z. Niçe. Përkundrazi, m'u dukët një i mençur që me keqdashje ju kanë marrë për të çmendur.

Qeshi me dashamirësi. U ngrita e i zgjata dorën, por ai më kapi nga krahu dhe më përcolli deri jashtë portës, më përqafoi fort dhe papëruar mbushën sytë me lot. Unë nisa të ecja rrugës që të çonte në Vajmar duke mbajtur me zor valixhen me libra. Niçja më thirri të ndalesha dhe m'u afrua.

-U nise në këmbë me gjithë valixhe?

-Avash-avash, z. Niçe.

-Në asnjë mënyrë! Prisni.

U kthye, shkoi te portieri, i tha diçka e pas pak erdhi një pajton i bukur, i hequr nga dy kuaj brymësa.

-Hipni dhe udhë e mbarë! - më uroi filozofi i madh.

U preka nga ai gjest bujar, e përqafova sërish, hipa në karrocë dhe karrocieri u grahu kuajve.

Në fund të qershorit të viti 1994, në kuadrin e ndihmës së mjekëve amerikanë për të sëmuret tanë, në pavijonin tim erdhi Prof. Hardi, një psikanalist e psikiatër i shquar. Psikanalisti është astrologu i leximit të qiellit të mistershëm të shpirtit njerëzor.

Cili shtet perëndimor nuk e ndihmoi vendin tonë në vitet e para pas përmbyesjes së madhe? Kushedi sa maune me rroba, lodra kalamaish, kompjutera, ushqime, një pjesë për qentë e macet, u shkarkuan te ne. Shumica u vodhën duke krijuar brenda natës një grusht pasanikësh të rinj, po kjo është punë tjetër. Se edhe pasanikët duhen, pavarësisht se si e fillojnë, me vjedhje a me djersë. Por ndihma në fushën e mjekësisë ishte serioze. Atë ditë Prof. Hardi kishte vizituar shumë pacientë dhe dukej i lodhur. Ishte dita e tij e fundit në spitalin tonë dhe të nesërmen do të nisej për në Bosnje.

Unë po rrija te dritarja e mesores së spitalit dhe kundroja sheshin e mbushur me vetura, murin e SHIK-ut, çatitë e ndërtesave, lëvizjen e njerëzve, qoshkun e perimeve dhe të pijeve freskuese, çatinë e klubit ngjitur me murin e spitalit, një jevg që shiste banane te kangjellat dhe, kur u lodha së pari, u largova nga dritarja duke folur me vete. Ndërkohë që ecja mesores për të shkuar në dhomën time, diç m'u kujtua e ia dhashë të qeshurit.

Më kishin vënë në dhomë më vete si privilegj që kisha qenë i burgosur politik, por edhe ngaqë e mbaja dritën ndezur tërë natën.

Teksa po hyja në dhomën time pashë se në mesore po kalonte Prof. Hardi, i shoqëruar nga Prof. Hysa. I trembur se mos më vizitonte mjeku i huaj, se kush duronte llogje për ndonjë gjysmë ore, nxitova të hyja në dhomë. Mirëpo sesi më shkau nga buzët fraza në anglisht, Ja dhe Hipokrati i të lajthiturve, dhe Prof. Hardi më dëgjoi. Buzëqeshi dhe u interesua për mua. Hyra në dhomë dhe teksa po bëhesha gati të mbyllja derën, dy mjekët qëndruan përpara saj.

-Mund ta shoh? - e pyeti Prof. Hardi Prof. Hysën në anglisht.

-Me kënaqësi. Është rast *çrregullim i personalitetit të shumëfishtë*, i përmirësuar ndjeshëm - ia ktheu Prof. Hysa.

Dr. Hysa u kthye nga unë e më tha se Profesori i shquar Hardi, i ardhur nga Amerika, donte të bënte një bisedë me mua. Me fjalë të tjera, të më vizitonte. Mua më hipën kacabunjtë.

-Ju më keni thënë se tashmë jam normal brenda anormalitetit tim dhe se do të dal, apo jo?

Dr. Hysa buzëqeshi e ma ktheu me ton miqësor:

-Megjithatë, nuk mund t'ia prish. Ne i presin mysafirët me nderim, aq më tepër një filozof si ju. A nuk po studioni filozofinë e Zenunit?

-Zenonit - ia ktheva. E kishte përsëritur disa herë atë ngatërresë dhe më vinte keq që një goxha Profesor të mos dallonte filozofin e madh Zenon, themeluesin e stoicizmit, nga një dikush që mund të quhej Zenun.

Vizita zgjati më tepër nga ç'kisha pandehur. Prof. Hardi kishte fytyrë të hijshme, sy depërtues, hundë zhgabonjë e një zë paksa të ngjirur. Kot kisha thënë se i ngjante Hipokratit; në të vërtetë i ngjante Marlon Brandosë në rolin e kryemafiozit te filmi *Kumbari*, por nuk ia thashë. Për Prof. Hardin përkthente Dr. Hysa, po një herë unë

fola anglisht përpara tij dhe Prof. Hardi u habit.

-Dini anglisht?

-Lexoj, po nuk flas dhe aq mirë.

-E keni mësuar këtu apo keni qenë në Angli?

-Këtu. Vetëm në dy vende të jashtme kam qenë, në Kosovë e Itali.

-Kur? - më pyeti, duket për t'u siguruar se mos fantazoja.

-Në kohën e Dullës.

Ndërhyri Dr. Hysa dhe Profesori i huaj e mori vesh përse bëhej fjalë. Vizita vazhdoi me pyetje e përgjigje dhe u përqendrua te vitet e burgut, te tema e humbjes së lirisë për individin, si ndikon ajo psikologjikisht tek ai dhe unë s'pushova së foluri për librat që kisha lexuar. Prof. Hardi u habit me numrin e titujve që përmenda. Kur i thashë se qeshë takuar me Zenonin, stoikun e madh të lashtësisë, nuk u habit, madje tundi kokën në shenjë miratimi.

-Edhe vetë kam qenë një biçim filozofi, - i thashë. - Një filozof i gabuar, i burgosur jogabimisht nga diktatura.

Prof. Hysa e hodhi bisedën me marifet te krimi që kisha bërë, për të cilin i kisha folur në një çast turbullimi dhe të cilit Prof. Hardi i dha rëndësi, nga ana mjekësore, dua të them, pasi më pyeti gjerë e gjatë, herë si mjek e herë si hetues, se kë kisha vrarë, ku, kur dhe pse. Këto do t'ia them vetëm varrit, ia ktheva Prof. Hardit, i cili nuk hoqi dorë nga përpjekja për të më nxjerrë ndonjë fjalë me grep, po unë e qepa.

Në fund më tha se do ishte në dobi të shërimit tim që kur të dilja nga spitali të shkruaja një autobiografi të përmbledhur të jetës sime nga fëmënia e deri më sot, rreth 30 faqe, t'i përktheja në anglisht dhe t'ia jepja vitin tjetër, se kishte në plan të vinte përsëri në Shqipëri. Më dha fjalën se shënimet do t'i lexonte vetëm ai e askush tjetër, fjalë burri, tha, të mos kisha merak. I duheshin për të bërë psika-nalizën time, çka do të shoqërohej edhe me pyetje gojore për ndonjë hollësi rreth fakteve të *Autobiografisë*.

U mendova gjatë për këtë sugjerim. Nuk dija sa do të isha në gjendje të shkruaja. Në spital, ndryshe nga në burg, nuk kisha mundur të hidhja në letër asnjë rresht. Po kur ndesha sërish vështirimin dashamirës të Prof. Hardit më erdhi keq ta kundërshtoja dhe i thashë se pranoja. U gëzua e më rrahu supin miqësisht. I tha Prof. Hysës se diagnoza e përcaktuar prej tij, *Multiple Personality Disorder*, kishte gjasa të ishte e saktë, por gjithsesi do të thellohej në rastin tim, se mund të ishte edhe *Post-traumatic Stress Disorder*, çka do ta saktësonte

pasi të kishte lexuar *Autobiografinë* time. Meqenëse nuk isha agresiv, edhe ai ishte i të njëjtit mendim me kolegun e tij shqiptar se mund të dilja nga spitali.

Gjatë bisedës na sollën kafe e biskota, bëmë edhe shaka. Prof. Hardi hapi çantën, më dha kartëvizitën e tij dhe më tha se po të doja, mund t'i shkruaja. Në fund më dha dorën dhe doli i shoqëruar nga Prof. Hysa.

Atë natë, nata e fundit në spital, ku qëndrova i shtruar 2 vjet, deri në fund të qershorit 1994, lexova e rilexova disa libra të tjerë për filozofët e lashtë grekë, ndër ta *Apologjia e Vërtetë e Sokratit*, që më pëlqeu shumë. Siç më kishte ndodhur edhe dy herë të tjera, përsëri u zhdukta nga dhoma e spitalit pa lënë gjurmë.

Nuk e mora vesh sesi u gjenda sërish në rrugët e Athinës së vjetër, çka më gëzoi pa masë. Ishte ardhja e dytë pas së parës, kur isha takuar me Zenonin e Madh, por që tani, po t'i referohesha kronologjisë, ai ende nuk kishte lindur.

Rrugët pak a shumë i njihja, ato kryesoret, sigurisht. Kudo mbretëronte pastërtia e rregulli, njerëzit shëtisnin, psonisnin nëpër dyqane, ndonjë pasanik ecte në koçi, skllevërit shoqëronin fëmijët e pronarëve për në shkollë, ushtarët bridhnin të kapardisur me mburoja, shpata e harqe, megjithëse këmbë armiku nuk dukej kurrkund.

Mbërrita në agora e u ndala pranë qoshkut të një shitësi që ndodhej matanë tezgës së mbushur me zarzavate, ullinj, rrush, banane e fruta të tjera dhe përtokë, anash saj, me qypa me vaj ulliri, verë e mjaltë. Sapo ishte larguar zyrtari që kishte kontrolluar peshoren se mos shitësi i hante klientët në peshë. Si duket e kishte gjetur në rregull, se shitësi vërshëllente i gëzuar një këngë. Sa më pa, e ndërpreu vërshëllimën e m'i nguli sytë. E kuptova, i kishte bërë përshtypje veshja ime: një pardesy e vjetër ngjyrë bezhë, e ngrënë te bërrylet, një triko e vjetër golf, një shall i kuq dhe këpucë alpine gjysmë të grisura.

-Më falni, - i thashë, - e dini ku banon Sokrati?

-Cili Sokrat? Se i ka nja 50 Athina. Mos keni fjalën për atë hidhnakun thumbaxhi që u vinte hakut pushtetarëve?

-Pikërisht. Po pse thoni *u vinte*? Nuk u vjen më?

-Ç' do t'u vijë, kur e kanë rrasur brenda?

-Ku brenda? Në burg?

-Në burg, po ku? Eh, ç'burrë ishte, mor zotni! Njeri i rrallë. I zgjuar e shakaxhi si ai. I dhimbej fukarai. Miq e shokë fukarenjtë kishte, megjithëse thonë se ishte *fillozof*. Po ç'*fillozof* ishte, kur i jepte gojës si shumë? Kjo e mori më qafë.

Në ç'kohë paskam ardhur!, thashë me vete i pikëlluar. Si nuk e kisha menduar këtë mundësi kur nga librat e dija ç'i kishte ndodhur Sokratit? E kisha pasur vetë në dorë të zgjidhja cilën kohë të doja për të ardhur, po tani që kisha ardhur, nuk zhbëja dot asgjë.

-E di, - ia ktheva i mërzhitur. - E di fundin e tij.

Shitësi më pa me habi. Kur e dija, pse e kisha pyetur? Po nuk kisha nge të merresha me llogje, Sokratin mund ta ekzekutonin nga çasti në çast dhe më duhej të nxitoja.

-Më fal, po kam dhe një pyetje. Ku është burgu?

-A, është larg, në Pentel, në një brinjë mali ku nxirret mermer. Duhet taksi për atje.

E kishte fjalën për koçinë, po nuk dija sa bënte. Le që ku kisha para? Kisha vetëm ca lekë shqiptarë e nja 20 dollarë, po ku më vlenin? Kur kisha vizituar Zenonin kisha punuar me ca skllevër, kisha shkarkuar fuçi me ullinj, po ku kisha kohë të bëja ndonjë punë tani? Gjithë sa kisha me vete ishte një kamë me një mill të bukur të zbukuruar me gurë të çmuar, mall i vjetër krutan. E kisha marrë për rrugës, të mbrohësja nga ndonjë hajdut.

U mendova një hop dhe nxora kamën.

-Të pëlqen?

Shitësit i ndritën sytë. E mori në dorë dhe e pa me kureshtje.

-Nga vini - më pyeti. - Nga Azia e Vogël?

-Jo, nga Shqipëria. Kufi me vendin tuaj.

-Nga, nga? Nuk e kam dëgjuar. Mos e keni fjalën për Ilirinë?

-Pikërisht. Po sot quhet Shqipëri.

-Pse, kur e ndryshoi emrin? Se ne nuk para komunikojmë me atë vend *barbarësh*.

-Mba gojën! - ia ktheva me inat. - Nuk jemi barbarë. E blen këtë kamë, apo jo?

-Jo, nuk jam aq i pasur. Mbase e blen ai bankieri atje, te qoshku. Është edhe kambist.

Mërmërita një si falënderim nëpër dhëmbë e shkova te qoshku i bankierit. Prita sa mbaroi punë me dy klientë, një afrikan e një aziatik, nxora kamën dhe ia tregova nëse i pëlqente.

Atë kohë u afrua një burrë i pashëm me pamje autoritare, me një fytyrë të ngrysur e të sertë, me siguri ndonjë afendiko pasanik, ndonjë magjistrat i lartë apo arkond¹ areopagas², i veshur me sqimë, me një xhokë shajaku të gjatë deri në mes, zbukuruar me dizenjo figurash gjeometrike ngjyra-ngjyra, nën të cilën mbante një tunikë leshi bojë hurme të punuar mjeshtërisht, me një palë këpucë boksi viçi shumë të bukura, kurse në brezin e leshtë me ngjyra si të ylberit mbante një shpatë. E shoqëronte një zeshkane e re, e lezetshme, me sytë e buzët lyer e ngjyer. Afendikoi kërkoi të këmbente ca dhrahmi në monedhë fenikase, se do të nisej për në Feniki. Bankieri rrotullonte kamën në duar, dukej sheshit se i pëlqente.

-E bleni? - e pyeta.

-Sa kërkoni?

-Dhjetë mne³.

-A, kërkokeni shumë.

-Sa jepni ju?

-Shtatë.

-Po është me gurë të çmuar! - i thashë. - Vlen më shumë se dhjetë.

Bankieri ishte në mëdyshje. Prisja me ankth përgjigjen e tij, po fundja mund t'ia jepja edhe për aq, se isha me ngut. Pashë se edhe afendikoi po e kundronte kamën me ëndje dhe, për habinë time, tha:

-E blej unë.

Bankeri ia dha dhe afendikoi nisi ta rrotullonte në duar me kënaqësi e kureshtje. Kurse zeshkania s'e kishte mendjen te kama, më shikonte mua e sikur po më hante me sy. Duhej të ishte ndonjë nga prostitutat e shumta të Athinës, mbase nga ato të bordellove poshtë Akropolit, që i kisha parë dikur, kur kisha kaluar andej me Zenonin. Afendikoi nxori nga xhepi i xhokës dy monedha pesëshe, m'i zgjati e më tha:

-Urdhëroni, dhjetë mne.

I mora metelikët, që vlenin sa një rrogë mujore e një sofisti të Lindjes, nga ata që bridhnin rrugëve të Athinës duke përhapur dijet e tyre, dhe i futa në xhepin e pardesysë, kurse afendikoi e futi kamën nën xhokë dhe vazhdoi punën me bankierin.

-Është zotni i madh, - kinse më pëshpëriti bankieri në vesh, po

1 magjistrat i lartë në Athinën e Vjetër

2 anëtar i Areopagut, Gjykatës së Lartë

3 monedhë që përdorej në Greqinë e Lashtë me vlerë 100 dhrahmi të atëhershme

dukej sheshit se ia kishte qejfi që këto fjalë t'i dëgjonte afendikoi. - Merret me tregtinë e drithit.

-Ku rrinë taksitë? - pyeta bankierin. - Jam i huaj dhe nuk e njoh qytetin.

-Meqenëse qenkeni i huaj, ju çon koçiarin im ku të doni, - më tha afendikoi. - Unë me zonjzën do të pimë nga një kupë verë. Po të doni, mund të na shoqëroni, kemi kënaqësi.

U habita. Dukej njeri i sertë, po paskej qenë zemërmirë.

-Ju falënderoj shumë për ftesën, - i thashë, - po kam një punë me ngut. Dua të shkoj në burg të takoj Sokratin, filozofin. Nuk di a është ende gjallë.

Fytyrën e afendikoit e mbuloi një shprehje keqardhjeje. Ose e kishte njohur Sokratin nga afër, ose do të kishte formuar mendim të mirë për të nga ç'kish dëgjuar, kush e di.

-Gjallë është lumëmadhi, - më tha, - po ditët i ka të numëruara. Gaboi rëndë, shumë rëndë... Ishte aq i zgjuar sa ta kuptonte se nuk duhej të gabonte. Përmendi në gjyq emra që s'duhej t'i përmendte, pushtetarë që bëjnë spekulime me minierat, me tokat e me armaturat e anijeve. Ato që dinte ai i dinë dhe të tjerë, po kush guxon të hapë gojën?

M'u afrua fare pranë e më pëshpëriti:

-I bëni të fala nga unë, Anaksimen Drithari. Po urdhëroj koçiarin t'ju çojë sa më parë, për ndonjë orë ndodheni në Pentel.

E falënderova me gjithë zemër. Paska dhe pasanikë të mirë, thashë me vete. Anaksimeni i bëri shenjë koçiarit që rrinte ulur në një koçi të bukur në anë të rrugës, i cili u avit dhe i zoti i shpjegoi si ishte puna.

Hipa në koçi e u nisëm. Ishte një udhëtim i këndshëm, ndonëse koçia troshitej për drejt në rrugën me kalldrëm. Penteli nuk ishte fort larg, rreth 5 km, dhe për ndonjë orë u ndodha te porta e burgut. I thashë koçiarit të mos largohet sa të hyja, që rojat të besonin vërtet se shkoja nga ana e Anaksimen Dritharit. Koçiarin u tregua i dashur, më shoqëroi deri te porta e madhe, madje bisedoi me shefin e rojave, i cili jo vetëm më lejoi, po pati nderin të më shoqëronte vetë deri te qelia e Sokratis. I tha gardianit të më lejonte të hyja në qeli dhe u largua.

Hyra. Roja doli duke tërhequr derën e rëndë prej hekuri dhe u dëgjua kërcitja e një llozi.

Sokrati rrinte ulur në krevatin e drunjtë, mendohej e fërkonte mjekrën. Vinte shulak, me flokë të rralluar, të thinjur, kurse mjekrën e

kishte të dendur. Kur hyra nuk e ngriti kokën për të më parë. Me siguri kishte kujtuar se po i çonin pjatën e supës, se ishte kohë dreke.

-Përshëndetje, z. Sokrat i Madh - i thashë e i qëndrova përballë.

Sokrati u ndërmend, ngriti kokën e më pa. Nuk foli, po me sy më pyeti se kush isha, nga vija e ç'qëllim kishte vizita ime. Mbase më mori për ndonjë ambasador të huaj a përfaqësues i Areopagut, i autorizuar për t'i thënë se do t'i falej jeta po të pranonte këtë e atë e kështu me radhë.

-Jam nga Iliria - i thashë. - Vij që andej t'ju përshëndes. Kam dëgjuar për famën tuaj dhe për dënimin tuaj, po nuk besoja se do ta zbatonin. Është e përbindshme t'ju dënojnë pse shprehni lirisht mendimet që keni!

-Eh, mor bir, - më tha. Më quante bir, si duket i ngjaja i ri, ndonëse isha 44 vjeç. - Mos më ka ndodhur vetëm mua! Janë dënuar plot të tjerë para meje dhe kam frikë se dhe të tjerë do të dënohen, derisa mendja e pushtetarëve të ndriçohet sa ajo e mendimtarëve. Po se kur do të ndodhë kjo, nuk i dihet.

Desha t'i thosha se edhe mua më kishin dënuar për mendimet e lira që kisha shprehur ose, më saktë, kisha shkruar, po nuk doja ta mbaja gjatë me muhabet për punën time, se kohën e vizitës e kisha të kufizuar.

-Po ç'e mirë të solli? Erdhe në Athinë për ndonjë punë dhe more vesh për mua?

-Jo, kam ardhur apostafat për t'ju takuar. Dhe u gëzova shumë që ju gjeta gjallë. A thoni se e kanë me gjithë mend t'ju ekzekutojnë?

-Pa pikë dyshimi.

-Po si është e mundur? Ju jeni demokraci. Athinën e njeh gjithë bota për liritë qytetare dhe vetjake të njeriut.

-Eh! Është gjoja demokraci, mor bir. Këta që janë në pushtet, arkondë, areopagas e magjistratë janë aq të pangopur për pasuri sa dhe Tridhjetë Tiranët. Po njësoj e rrjepin fukaranë. Mashtruan vulgun, i premtuan begati, u morën votat dhe vendosën një tjetërlløj oligarkie, tani demokratike! Pika demokracisë së tyre! Po te ju kush e qeveris vendin, burra të urtë a maskarenj?

-Më të shumtën e kohës maskarenjtë e kanë qeverisur, - i thashë. - Edhe unë jam marrë me politikë, ashtu, në fshehtësi. Me profesion jam jurist dhe më futën në burg për ato që shkruaja. Gjene kam qenë me fat, se të tjerë i kanë pushkatuar...

-Ç'u kanë bërë? - më pyeti me habi.

E kapa gafën, kisha përdorur një fjalë që Sokrati s'e kuptonte, ndaj nxitova ta sqaroja.

-I kanë vrarë me arbaleta¹, - i thashë. - Në burg u çmenda, po tani jam më mirë. Vetëm leximi ma mban gjallë arsyen. Lexoj shumë, kam lexuar edhe vepra nga tuajat.

-Çudi si ka mbërritur ndonjë kopje deri te ju, - më tha. - Se kur më futën në burg, më dogjën gjithë ç'kisha shkruar. Pak kisha shkruar, se mësimet i jepja gojarisht, po më erdhi keq. Të paktën të kishin mbetur ato pas meje.

I thashë se shumë nga mësimet e tij do ta tejkalonin kohën, do të mbijetonin në shekuj. Sokrati më pyeti pse e quaja veten të çmendur kur flisja me aq urtësi. I thashë se gjysmën e mendjes e kisha në rregull, kurse gjysma tjetër kishte një diagnozë me një emër të ngatërruar. Gjysmën e saktë e kisha të etur për filozofime, i thashë, me aq sa ma priste kaploqja, se nuk shquhesha për to, ama e kisha të çliruar nga dogmat, klisheetë, paragjykimet, e kisha të lirë në kuptimin të çliruar nga mendësia e rëndomtë, përditësore, me një fjalë e kisha diçka më të thellë se një mendje normale. Mendja ime, ajo e shëndosha, i thashë, përfaqësonte Shpirtin Universal për të cilin flisnin shkrimet ezoterike e mistike *Upanishada*, apo diçka si *Shpirti i Lirë* i Niçes.

-I kujt? - më ndërpreu Sokrati.

U pendova që kisha përmendur Niçen, i lindur 2.500 vjet më vonë, po e ndreqa shpejt, i thashë se ishte një filozof i vendit tim që mbronte teorinë se ekziston një Shpirt Universal nga i cili burojnë të gjithë shpirtrat e individëve, një ide që m'u duk se i pëlqeu.

-A mund të jetë i qetë shpirti kur ka një zgërbua në të, amulli, mungesë hajmalie, a nuk kërkon ai shpjegim përtej asaj që sheh, dëgjon e prek, a nuk do ai të jetë i lirë nga ca rëndomësi si uria apo dëshira seksuale, a nuk do ai të ngrihet mbi ndjenjat e zakonshme hedoniste² kur është i pajisur me transhendencë³? A i mjafton atij të ushqehet nga një racionalizëm praktik apo imagjinar, çka është veti e çdo vetëdijeje? Jo, vazhdova me patos, ai do kozmosin e thellë, synon drejt origjinës së vet si emigranti drejt atdheut të vet...

1 një lloj harku i fuqishëm prej hekuri

2 që i përbahet doktrinës sipas së cilës kënaqësia është e mira më e madhe

3 përvojë e brendalindur te njeriu, dije e pakapshme nga përvoja (sipas Kantit)

Pashë se Sokrati po më ndiqte me vëmendje. Heshta pak e vazhdova:

-Nuk ka shpirt të varfër tek asnjë njeri. Edhe krimineli beson në diçka, beson në instinktin e pagabueshmërisë së tij, te një drejtësi që ekziston për të, e shpikur prej tij, që për ligj krimin e tij, ose të paktën beson në zotësinë e vet se do ta hedhë lumin pa u lagur. Sepse cili kriminel shkon në vetëflim pa një motiv? Edhe një vetëflijues beson në parajsën ku do t'i prehet shpirti a në të mirën që do t'i sjellë vendit akti i tij, ose në drejtësinë apo ligjshmërinë e aktit të tij, të cilin nuk e quan krim. Po edhe te një njeri që kryen një krim jo për motive të larta, as për pasion a xheloz, po thjesht nga lakmia - si në një fshat të vendit tim ku dy të rinj kryen një krim makabër dhe i varën në litar - besimi mishërohet në *fat*in që do ta ndihmojë në moszbulimin e krimit, apo në besimin te Djalli, që e sheh si engjëllin mbrojtës. Unë them se as krimineli nuk ka krizë besimi në shpirt.

Sokrati u mendua gjatë para se të fliste dhe më pa me simpati të dukshme, madje me admirim.

-Fole me vend, mor bir - më tha. - S'ka njeri në shpirtin e të cilit nuk zë vend besimi. Ka njerëz që besojnë te Zoti a te Shpirti Universal, siç thatë ju, ka që besojnë vetëm te bota që na rrethon dhe jashtë saj nuk ka kurrfarë shpirti, besojnë te vdekja dhe te asgjë tjetër përtej saj, ka njerëz që besojnë vetëm te paraja, te fitimi, dhe në djall të venë shenjtëria, perëndishmëria, morali që mban në këmbë qytetërimin. Ka gjithfarësoj njerëzish, madje edhe njerëz që besojnë se s'ka asgjë për t'u besuar, se gjithçka është iluzore dhe e rrejshme. Unë për vete kam besuar, respektuar e adhuruar të drejtën, të mirën, të arsyeshmen; jam tallur me maskarenjtë që hiqen ndryshe nga ç'janë, që vënë maska si ato të teatrit, që i lëpihen vulgut sa t'i marrin votën e pastaj jo vetëm i kthejnë shpinën e s'duan t'ia dinë për të, por edhe e rrjepin. Këta i kam tallur pa mëshirë, ua kam nxjerrë bojën, ndaj dhe më dënuan. Po u cenove interesat, këta të ashtuquajtur demokratë të rrjepin të gjallë dhe fjala ime u digjte, se populli kupton, duron sa duron e pastaj ngre krye dhe i rrëzon nga pushteti, siç përmbysën Hipiasin, birin e Pisistratit. I ati që vërtet një lloj tirani, po sundoi në mënyrë demokratike dhe nuk që maskara si këta që më dënuan mua, gjoja përfaqësues të popullit! Tiran që Pisistrati, po mendimin e lirë nuk e dënoi!

Sokrati heshti një grimë e vazhdoi:

-Këta që hiqen si demokratë u sollën poshtërsisht jo vetëm me mua, por edhe me Alqiviadhin, një nga njerëzit më të ndritur që kam njohur. Sa u nis me flotën për në Sirakuzë, kurdisën thyerjen e statujave të Hermesit gjatë natës në Athinë dhe fajin ia ngjitën atij, po ai nuk kishte gisht në të, e bënë për ta dërrmuar dhe djaloshi, pikë e vrer, u hodh me spartanët e madje me persët, armiqtë tanë, jo se nuk e donte Athinën, po se donte të kthehej fitimtar në Athinë dhe të ndëshkonte të ligjtë. Si gjeneral që i shkëlqyer, u mori persëve tri qytete radhazi, u prit në Athinë me brohori, po një vit më pas fati i keq e ndoqi sërish, humbi një betejë detare dhe prapë u arratis. Po këta ia kishin bërë benë, e gjetën atje ku ishte, në Frigji, i dogjën shtëpinë dhe e bënë shoshë me shigjeta...

Sokratit iu mbushën sytë me lot, i rrodhën nëpër faqe dhe i kulluan në mjekër.

-E kam pasur mikun më të mirë, ndonëse ishte 20 vjet më i ri. E kisha këshilluar të mos kruhej me pushtetin, po ishte kokëkrisur dhe i thoshte sherrit ja ku jam. Tërë jetën i kurdisën poshtërsi, e kishin zili se shkëlqente nga të gjitha anët. Shumë të mirin dhe shumë të keqin nuk i duan kurrë. Mjerë ai që nuk lind mesatar.

-Po dhe ju u kruajtët me pushtetin, z. Sokrat... Nuk e zbatuat as vetë këshillën që i dhatë Alqiviadhit...

Sokrati më pa në sy me admirim dhe vuri buzën në gaz pikëllueshëm.

-Ke të drejtë, o bir. Kokëkrisur u tregova. Po ç' t'i bësh kësaj, - tha për gojën, - nuk e mbaja që nuk e mbaja dot mbyllur.

Nga dritarja me hekura shihja karrot e ngarkuara me blloqe mermeri të bardhë në faqen e malit përkarshi. M'u kujtua galeria kur punoja në burg, po m'u duk egoistike ideja e keqardhjes për burgimin tim kur Sokrati me sot me nesër do të pinte helmin, kështu që, për t'i dhënë bisedës një ton më të këndshëm, e pyeta për skulpturat që kisha dëgjuar se bënte dikur.

-Eh, kohë të arta! Të rinisë që nuk kthehet më...

U përmallua e u përlot. U çmerita që ai burrë aq i hidhtë në ironitë e tij, aq sarkastik për çdo gjë të mbrapshtë, të kishte një shpirt aq të butë sa të përlotej.

U dëgjua kërcitja e llozit. Hyri gardiani që më tha se koha e vizitës sime mbaroi dhe më tregoi një shtambë me ujë të ndarë në dy pjesë që maste kohën.

-Dhe dy minuta, - iu luta unë dhe ai doli. Sokrati vazhdoi:

-Po, kam bërë skulptura, punoja me babanë, po edhe vetëm. Skulpturoja femra lakuriq. Merrja vajza adoleshente, i paguaja, pozonin, i vizatoja, ndonjë e mbaja derisa mbaroja skulpturën, po kjo kërkonte që vajza të rrinte më shumë, që vetëm prostitutat e pranonin. Po këto drejka i kishin tarifat të larta. Thoshin se për aq orë do të kishin pasur aq e aq klientë. Hollë-hollë qejfi ma kishte të skulpturoja vajza adoleshente, po ato rrallë janë prostituta. Zakonisht femrat hyjnë në këtë zanat pas të njëzetave.

Sokrati heshti pak, u ngrit nga krevati dhe hodhi shikimin nga dritarja me një ndjenjë përmallimi të thellë në sy. Skllevërit vazhdonin të ngarkonin karrot me blloqe mermeri.

-Ja, vija këtu me babanë, po shkonim edhe në Himetus, se dhe atje kishte mermer të mirë. Kishim skllevër atëherë, më pas i shitëm, ramë nga vakti, dy mbajtëm. Më vinte keq për skllevërit, i mbanim mirë, nuk i mundonim, po skllavi vuan, sado mirë ta mbash.

Heshti pak e vazhdoi:

-Si i mbaroja skulpturat, i soditja, dashurohesha me to e prapë i lëmoja deri në përsosmëri. Po guri gur mbetet, sado i bukur qoftë, nuk ka si trupi i gjallë i femrës... Këtu besojnë në shumë perëndi, po unë besoj vetëm në një - tek Ai që nëse nuk ka krijuar botën, ka krijuar njeriun, femrën, gjënë më të bukur të kozmosit...

Hyri përsëri gardiani, që këtë herë nuk pranoi shtyrje kohe. I zgjata dorën Sokratit, por ai, i prekur në kulm, më përqafoi e më puthi. Para se të dilja, në çastin e fundit, e pyeta:

-I dashur Sokrat, a mund të dojë mashkulli dy femra njëherësh?

-Edhe mund, - m' u përgjigj. - Më ka ndodhur kur isha i ri. Më i ri se kur u martova me Ksantipin. Nuk e kam fjalën për rastin kur ajo ma solli në majë të hundës dhe u dashurova me një vajzë të re, me të cilën u martova.

Duket u mallëngjye nga kujtimet për femrat, se shtoi: - Megjithatë, mashkulli vetëm një femër mund të dojë në jetë. Ajo quhet *kryedashuri*, ose dashuri *demoniake*. Më kupto drejt, o i huaj i dashur, demoni është shenjt dashamirës, udhëheqësi më i drejtë në jetën e njeriut. Kur s' e ka më atë të dashur për arsye nga më të ndryshmet, mashkulli do të dojë një tjetër në vend të saj, çka ia zbut disi dhimbjen për mungesën e së parës. Po dhimbjen për të nuk e harron deri në varr.

Gardiani po bëhej gjithë nerva, ishte gati të më kapte nga zverku

e të më flakte jashtë qelisë.

-Faleminderit, bir, - më tha Sokrati. - Qofsh i bekuar që i fale ca minuta të bukura një plaku në prag të vdekjes, bëju të fala miqve të tu, sidomos atij *Nikes*, sa emër të bukur paska, tingëllon si *nikea*...

-Nëse ka një Zot në qiell, një ditë do të takohemi atje - i thashë e më mbytën lotët. Pastaj i hodha një sy të fundit atij plaku të urtë dhe bëra pas gardianit, i cili mbylli derën e më shoqëroi deri jashtë, ku pashë se po më priste koçari.

Nuk mbaj mend a hipa në koçi apo jo, se u zhyta në mjegullinë, në një turbullirë shpirtërore e madje nuk mbaj mend as se si u largova nga Athina. Po bisedën me Sokratin dhe imazhin e tij i ruaj të freskëta në kujtesë edhe sot e kësaj dite dhe më duket sikur në zemër kam një ikonë të shenjtë, që e di vetëm unë.

Një ditë Pirroja më solli një tufë me gazeta, më sillte herë pas here, në të cilat lexoja ndonjë shkrim sociologjik, analitik e filozofik, ndonëse nga këta të fundit rrallë dilnin. Më pëlqenin sidomos shkrimet e Fatos Lubonjës, sepse kishte aq kthjelltësi, thjeshtësi e madhështi mendimi në to. Kurse një artikull i shkruar nga një studiues i huaj i letërsisë sonë më ngriti nervat. Thoshte, Boll më me diktaturën dhe burgjet e saj. Më vinte plasje që nuk isha në gjendje të shkruaja, sidomos për burgjet, se do të kisha bërë një artikull për gazetën e do t'ia jepja Pirros ta çonte. Ama e shkrova me mend.

Nëse ndonjë kritik i huaj, e fillova, shpreh mërzi nga reminishencat tona të tmerrit që kaluam, bën mirë të shohë më thellë që të bindet se burgjet e diktaturës sonë të *proletariatit* nuk mbeteshin prapa burgjeve fashiste. Bën mirë të hulumtojë faktet, dëshmitë apo filmimet që dokumentojnë kushtet në këto burgje. As burgjet staliniste nuk kanë qenë kaq çnjerëzore. Të burgosurit në to nuk viheshin nën tortura dhe gëzonin disa liri që ne as mund t'i ëndërronim.